



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE

Nr. ____ Prot.

Tiranë më, ____/____/2024

V E N D I M

Nr. 21, datë 08.03.2024

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

Bora Vrenjo	Kryesuese
Henri Naqellari	Relator
Loreta Hanxhari	Anëtare

Asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga anëtarja e Sekretariatit Teknik, Znj. Ersila Kalaja, në orën 09:30, datë 08.03.2024, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket:

SUBJEKTI I VLERËSIMIT:

Z. Ilir Agim Proda, me funksion Drejtor, në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

OBJEKTI:

Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Ligji nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, (këtu e në vijim Ligji nr. 12/2018, i ndryshuar).

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,

pasi dëgjoi relatimin e relatorit të çështjes Henri Naqellari, dëgjoi subjektin e vlerësimit Ilir Agim Proda, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 01.03.2024, kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi, duke u bazuar në tre kriteret e vlerësimit, të pasurisë, të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2, të nenit 4, të Ligjit nr. 12/2018 të ndryshuar,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Agjencia e Mbrojtjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbrojtjes Policore, bazuar në Ligjin nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.
2. Sipas përcaktimeve të nenit 2, nenit 4 dhe nenit 6, të Ligjit nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, Z. Ilir Proda është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Trupat e Vlerësimit të Agjencisë së Mbrojtjes Policore, për shkak të funksionit të tij në datën e zhvillimit të shortit 05.04.2023, si Drejtor, në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
3. Subjekti i vlerësimit, Z. Ilir Proda, i'u nënshtrua procedurave të vlerësimit, duke u shortuar në shortin e zhvilluar në datën 05.04.2023 nga Trupat e Vlerësimit, në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 7, datë 17.01.2023 “Për procedurat e hedhjes së shortit”.
4. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, me Vendimin nr. 01, datë 18.04.2023, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e Trupës së Vlerësimit të përbërë nga: Z. Henri Naqellari Relator, Znj. Bora Vrenjo Kryesuese dhe Znj. Loreta Hanxhari Anëtare.
5. Trupa e Vlerësimit, në përputhje me Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar, si edhe në bazë të Rregullores nr. 197, datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar”, me Vendimin nr. 01, datë 18.04.2023, vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Ilir Proda.
6. Relatori i çështjes Z. Henri Naqellari, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar datë 18.04.2023, ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, dhe i është bërë e njohur përbërja e Trupës së Vlerësimit, duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e Trupës së Vlerësimit.

7. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar deklaratën për konfliktin e interesit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, në datën 24.04.2023, duke shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e Trupës së Vlerësimit.
8. Relatori i çështjes, në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3, të nenit 25, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.
9. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, Trupa e Vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.
10. Bazuar në nenin 34, nenin 42 dhe nenin 46, të Ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar, janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (këtu e në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.
11. Në përputhje me nenin 34, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ILDKPKI me shkresë nr. ***, prot., datë 13.10.2023, (protokolluar me tonën nr. ***, prot., datë 17.10.2023), dërgoi raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të vlerësimit Z. Ilir Proda. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhurave të deklaruar nga subjekti i vlerësimit, është konstatuar se:
 - Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;
 - Nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
 - Nuk është kryer fshehje e pasurisë;
 - Nuk është kryer deklarim i remë;
 - Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.
12. Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të vlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i vlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 42, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit, me shkresë nr. ***, prot., datë 23.08.2023, ka dërguar raportin e saj për subjektin e vlerësimit, në përfundim të të cilit ka konstatuar se nuk administrohen të dhëna, fakte apo prova, që punonjësi është i përfshirë ose i dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, apo që të tregojë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.

- 13.** Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke analizuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i vlerësimit gjatë periudhës objekt vlerësimi, të dhënat e mbledhura në institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese në Republikën e Shqipërisë. Në zbatim të nenit 46, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, me shkresë nr. ***, prot., datë 30.06.2023, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e vlerësimit, në përfundim të të cilit ka konkluduar se:
- Është i përshtatshëm duke patur arsimin/trajnimin përkatës për funksionin;
 - Ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban.
- 14.** Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 25, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi tre kriteret: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale.
- 15.** Trupa e vlerësimit, më datë 13.02.2024, pasi dëgjoi relatorin, dhe pasi krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kishin nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatoi se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Ilir Proda, me Vendimin nr. 03, datë 13.02.2024, vendosi:
- a. Të mbyllë hetimin kryesisht, për subjektin e vlerësimit Z. Ilir Proda;
 - b. Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:
 - ✚ *Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht;*
 - ✚ *Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët, të vlerësimit pasuror, kontrollit të figurës dhe atij profesional.*
 - c. Të ftojë subjektin për t'u njohur me dosjen dhe me provat e administruara nga Trupa e Vlerësimit, në përputhje me nenin 50, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme prej 5 ditësh për t'u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.
- 16.** Subjekti i vlerësimit me shkresën nr. ***, prot., datë 16.02.2024, ka paraqitur dokumente shtesë lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, të cilat janë marrë në konsideratë nga Trupa e Vlerësimit dhe janë pasqyruar në vendim.
- 17.** Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur, në kuptim të nenit 3, pika 11, neni 5, i Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, si dhe nenit 34, pika 1, e Ligjit nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.

II. SEANCA DËGJIMORE

- 18.** Subjekti i vlerësimit u ftua në seancën dëgjimore publike, me njoftimin e bërë elektronikisht me email, në datën 28.02.2024.

19. Seanca dëgjimore me subjektin e vlerësimit, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, në datën 01.03.2024, ora 10:30, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, Tiranë, në prani të sekretariatit teknik.
20. Subjekti i vlerësimit Z. Ilir Proda, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur opinionin individual në lidhje me procesin e vlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim, subjekti kërkoi nga Trupa e Vlerësimit konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

21. Z. Ilir Proda ka qenë bashkëpunues në procesin e vlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur në kohë, sipas Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.
22. Subjekti i vlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I VLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA TRUPA E VLERËSIMIT

23. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve, bazuar në nenin 4, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar ka për objekt:
- Vlerësimin e pasurisë;
 - Kontrollin e figurës;
 - Vlerësimin e aftësive profesionale.
24. Trupa e vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:
- Ligjin nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar,
 - Ligjin nr.128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”,
 - Ligjin nr. 40/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”,
 - Ligjin nr. 49/2012, “Për Gjykatën Administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative”,
 - Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”,
 - Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 7, datë 17.01.2023, “Për procedurat e hedhjes së shortit”,
 - Rregulloren nr. 197, datë 23.02.2023, “Për hapat procedural të unifikuar”,
 - Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar,
 - Provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit,
 - Ka marrë në konsideratë bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit,
 - Raportin e dorëzuar nga ILDKPKI,

- Raportin e dorëzuar nga Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore,
- Raportin e dorëzuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit,
- Deklarata e Pasurisë,
- Deklarata për Kontrollin e Figurës,
- Formulari i Vlerësimit Profesional,
- Dokumentacionin bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklaratimet.

A. VLERËSIMI I PASURISË

25. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun III, “Vlerësimi i pasurisë”, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, dhe veçanërisht në nenin 31, të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e vlerësimit kalimtar dhe për personat e lidhur me të.
26. Në zbatim të nenit 32, pika 2, e Ligjit nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit Z. Ilir Proda, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë pranë strukturave përkatëse, e cila mban nr. index 01, viti 2023).
27. Procedurat e deklaramit të pasurisë kryhen sipas përcaktimeve të nenit 32 dhe nenit 33, ndërsa vlerësimi i pasurisë nga Trupa e Vlerësimit, kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
28. Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara, mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kryer verifikime në të gjitha institucionet apo personat juridikë, publikë apo privatë.
29. Gjithashtu Trupa e Vlerësimit ka mbajtur në konsideratë deklaratimet e dhëna nga subjekti për vërtetimet e të ardhurave për secilin vit kalendarik, të shoqëruara me dokumentacion zyrtar, raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, në zbatim të nenit 33/1 dhe nenit 34 të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, shpjegimet e subjektit për burimin e të ardhurave, mbulimin e shpenzimeve dhe të detyrimeve financiare, ka kontrolluar dhe krahasuar gjendjen pasurore dhe ndryshimet e saj në vite, burimin e krijimit, pagimin e detyrimeve financiare, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e vlerësimit dhe personave të lidhur me të.

Trupa e vlerësimit për realizimin e procesit të vlerësimit të pasurisë administroi:

- Deklaratën e pasurisë dhe dokumentacionin bashkëlidhur;
- Raportin e hollësishëm të përgatitur nga ILDKPKI;
- Provat shkresore/dokumente të vëna në dispozicion nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar;

- Dokumentacionin e paraqitur në deklaratimet e subjektit, si dhe përgjigjet e pyetjeve të dërguara nëpërmjet postës elektronike.

Hetimi administrativ konsistoi në:

- ✓ Verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve, në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;
- ✓ Verifikimin e burimit të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara, si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të ligjshme;
- ✓ Evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;
- ✓ Evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme, si edhe rasteve të konfliktit të interesit.

Deklarimi i pasurisë

Në mbështetje të nenit 33, pika 1/a, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, subjekti i cili i nënshtrohet vlerësimit, deklaron të gjitha pasuritë e akumuluar ndër vite deri në datën e dorëzimit të formularit të deklaratës së pasurisë, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, në pronësi, në posedim, në përdorim, ose të tjetërsuara nga subjekti i vlerësimit apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose me persona të tjerë si më poshtë:

- Pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to;
- Pasuritë e luajtshme të regjistrueshme në regjistrat publikë dhe të drejtat reale mbi to;
- Sendet me vlerë të veçantë mbi 300,000 lekë;
- Vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
- Vlerën e likuiditeteve, gjendje në kesh jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari, në huadhënie, apo mjete të tjera financiare, në lekë ose në valutë të huaj;

Në deklaratën Veting të dorëzuar në strukturat përgjegjëse, subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar se zotërojnë pasuritë si në vijim:

- 1.** Apartament banimi me sipërfaqe 52,9 m², me adresë rr. “****”, pll. ***, shk. *** ap. ***, blerë në datë 13.06.2012. Burimi i krijimit: a) Kredi bankare në Bankën Kombëtare Tregtare (këtu në vijim BKT), shuma 3,390,000 lekë. b) Kursime familjare dhe ndihmë nga babai i subjektit në vlerën 860,000 lekë. Vlera totale 4,250,000 lekë. Zotërimi 50%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitje pasuri të paluajtshme me kusht, nr. ***, datë 13.06.2012, me palë shitëse A. K, N. K, dhe palë blerëse Ilir Proda, të apartamentit me sip. 52,9 m², me nr. pasurie ***, Zk. ***, vol. ***, fq. ***, në adresën rr. “****”, pll. ***, shk. ***, kati ***, ap. ***, Tiranë, në vlerën 4,250,000 lekë, e cila do të likuidohet me kusht.
Shuma prej 800,000 lekë, është likuiduar nga pala blerëse me nënshkrimin e kontratës, shuma 3,450,000 lekë do të likuidohet me kredi nga banka BKT. Me likuidimin e vlerës 3,450,000 lekë, pala blerëse bëhet pronare e pasurisë.

- Kontratë kredi bankare nr. ***, datë 27.08.2012, me bankën BKT dhe kredi marrës Ilir Proda, dorëzuanës Zhanina Proda, Agim Proda, Majlinda Proda, A. K dhe N. K, të shumës 3, 390, 000 lekë. Sigurimi i kësaj kredie është vendosur mbi apartamentin me sip. 52, 9 m², regjistruar me nr. pasurie ***, Zk. ***, vol. ***, fq. ***, Tiranë, dhe mbi pasurinë Truall + ndërtesë me sip. 71 m², regjistruar me nr. pasurie ***, Zk. ***, në adresën Lagja “****”, Sarandë, në emër të Agim Proda. Afati i kredisë bankare është 20 vjet. Aneks i çeljes dhe përdorimit të kredisë datë 27.08.2012, nga BKT, që konfirmon se kredia në shumën 3, 390, 000 lekë do të përdoret për blerje apartamenti.
- Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 03.10.2012, të apartamentit me sip. 52, 9 m², në emër të Ilir Proda, regjistruar me nr. ***, Zk. ***, vol. ***, fq. ***, në adresën rr. “****”, pll. ***, shk. ***, kt. ***, ap. ***, Tiranë.

Procedura e vlerësimit:

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë kontrolli për asetin e mësipërm, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke analizuar të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion në funksion të hetimit administrativ, si dhe ka kryer verifikime në institucionet përgjegjëse, të cilat kanë dërguar përgjigjet përkatëse në lidhje me deklaratimet apo mos deklaratimet e subjektit të vlerësimit, e konkretisht:

Drejtoritë Vendore të ASHK - Tirana Rurale 1, Tirana Rurale 2, Tirana Veri, Zonat e Stimuluara, në përgjigjet e tyre, nuk konfirmojnë pasuri të regjistruar në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të.

BKT, me shkresën nr. ***, prot., datë 09.05.2023, konfirmon se shtetasi Ilir Proda ka kredi bankare në emër të tij. Bashkëlidhur, nxjerrje llogarie bankare, ku në datë 31.08.2012, është disbursuar kredia bankare në vlerën 3, 390, 000 lekë dhe transferuar vlera 3, 317, 000 lekë, me përshkrimin “*Likuidim detyrimi blerje apartamenti sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, në favor të A. K*”.

ISSH, me shkresën nr. ***, prot., datë 10.05.2023, konfirmon se shtetasja Majlinda Proda ka përfituar të ardhura nga punësimi pranë subjekteve, “Qendra Shëndetësore Sarandë, Shëndeti Publik Sarandë, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Sarandë”, për periudhën janar 2012 - mars 2023. Të ardhurat për periudhën janar 2012 - qershor 2012, janë në vlerën rreth 175, 788 lekë.

ISSH, në postën elektronike të datës 26.05.2023, ka bashkëlidhur tabelën përmbledhëse në emër të Agim Proda, i cili ka përfituar pension invaliditeti nga muaji gusht 2000 - dhjetor 2017 në vlerën 7, 572 lekë. Të ardhurat për periudhën gusht 2000 - qershor 2012, janë në vlerën rreth 1, 082, 000 lekë.

Në procesverbalin e datës 03.09.2023, subjekti sqaroi se sipas dokumentacionit të paraqitur, shuma 800, 000 lekë është paguar cash jashtë zyrës noteriale, ndërsa shuma prej 3, 450, 000 lekë do të realizohet nëpërmjet një kredie në BKT. Referuar BKT, në datën 31.08.2012 është disbursuar kredia prej 3, 390, 000 lekë, ku vlera 3, 317, 000 lekë ka kaluar për pagesën e kështit të dytë. Subjekti ka paguar cash edhe diferencën e mbetur, për të cilën nuk disponon mandat të pagesave, pasi shitja është realizuar midis individëve.

Në lidhje me shumën 860, 000 lekë, deklaruar si burim financiar, sqaroi se shuma prej 500, 000 lekë është ndihmë nga babai nga kursimet familjare të prindërve, pjesa tjetër kursime të tij dhe bashkëshortes.

Mobilimi i shtëpisë është kryer pjesë pjesë, me një vlerë rreth 400, 000 lekë, me burim kursimet familjare, por nuk disponon fatura, për shkak të kohës së largët. Shuma në fjalë është shpenzuar gjatë periudhës nga muaji qershor 2012 deri në muajin dhjetor 2014, kryesisht për nevoja emergjente, zëvendësimin e mobilieve të vjetra për shkak të amortizimit, si dhomë gjumi, sallon ndenje dhe elektroshtëpiake.

Bashkëlidhur sqarimeve, subjekti paraqiti:

- Vërtetim nr. ***, datë 30.05.2023, nga Qendra Shëndetësorë Sarandë, që vërteton se shtetasja Majlinda Proda ka realizuar të ardhura për periudhën 2007 - 2011, në shumën rreth 1, 694, 000 lekë.
- Vërtetim nr. ***, prot., datë 30.05.2023, nga Ujësjetës Kanalizime Sarandë, që konfirmon se Agim Proda ka përfituar të ardhura nga paga për periudhën 15.11.2003 - qershor 2012, në shumën 2, 213, 176 lekë.

Nga verifikimi i llogarisë bankare të subjektit të vlerësimit pranë Raiffeisen Bank, me nr. llogarie ***, konstatohet se më datë 28.03.2011, janë kredituar në llogari 300, 000 lekë nga babai Agim Proda dhe më datë 29.03.2011, kjo vlerë është tërhequr.

Subjekti i vlerësimit ka dhënë shpjegimet përkatëse, duke u shprehur se kjo vlerë është dërguar nga babai Agim Proda për ta ndihmuar të grumbullojë disa para, pasi në këtë periudhë ka qenë në kërkim për blerjen e një apartamenti.

Trupa e Vlerësimit me qëllim vlerësimin e ligjshmërisë së të ardhurave financiare si dhe vlerësimin e mundësisë për kursimin e vlerës me qëllim pagesën e pjesës së mbetur për likuidimin e blerjes së këtij aseti, si dhe për të mbuluar shpenzimet për mobilim, kreu analizën financiare përkatëse e cila ndodhet bashkëlidhur këtij relacioni (Aneksi 1).

Konkluzion:

Bazuar në deklarinimin e subjektit, sqarimet dhe dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga Trupa e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur rezultojnë se:

- *Apartamenti me sip. 52, 9 m², në rr. “***”, Tiranë, është përfituar me kontratë blerje në muajin qershor 2012, me burim kredi bankare, kursime familjare dhe ndihmë nga babai.*
- *Subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumentacion justifikues lidhur me burimin financiar të përdorur për blerjen e apartamentit, me sip. 52, 9 m², në rr. “***”, Tiranë, në vitin 2012.*
- *Deklarimi përputhet me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjen e BKT, lidhur me kredinë e disbursuar me qëllim blerjen e apartamentit.*
- *ASHK nuk konfirmon pronësinë e apartamentit.*
- *Subjekti i vlerësimit referuar analizës financiare, ka patur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme, me qëllim investimin e vlerës prej 360, 000 lekë.*

- *Personat e lidhur me subjektin e vlerësimit, referuar dokumentacionit të administruar, justifikojnë vlerën prej 500, 000 lekë, dhënë subjektit si ndihmë me qëllim blerjen e apartamentit.*
- *Shpenzimet e mobilimit janë deklaruar në vlerën 400, 000 lekë, të cilat referuar analizës financiare dhe dokumentacionit të administruar, justifikohen me burime të ligjshme nga subjekti i vlerësimit.*

2. Apartament banimi me sipërfaqe 119, 8 m², me adresë rr. “****”, pll. ***, hyrja ***. ap. ***, blerë në datë 28.01.2017, sipas kontratë porosisë datë 01.12.2014. Shuma 7, 000, 000 lekë. Investuar për arredim, shuma rreth 1, 000, 000 lekë. Burimi i krijimit: a) Huamarrje pa interes nga personi fizik 52, 000 euro ose ekuivalenca në lekë, sipas kursit të këmbimit të kohës 7, 000, 000 lekë, si dhe kursime dhe ndihmë financiare nga babai për arredim. Zotërimi 50%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitblerje e pasurisë së paluajtshme, nr. ***, datë 28.01.2017, me palë shitëse shoqëria “**** sh.p.k” dhe palë blerëse Ilir Proda, të apartamentit nr. ***, kt. ***, godina nr. ***, me numër pasurie ***, Zk. ***, vol. ***, fq. ***, me sipërfaqe banimi 119, 8 m², në adresën rr. “****”, Tiranë, në vlerën 7, 000, 000 lekë, e likuiduar totalisht në arkën e shitësit, sipas mënyrës së përcaktuar në kontratën e porosisë datë 01.12.2014. Kalimi i pronësisë do të bëhet menjëherë pas nënshkrimit të kontratës.
- Certifikatë datë 21.01.2021, për regjistrimin e pronësisë të apartamentit me sip. 119, 8 m², regjistruar me nr. ***, Zk. ***, në adresën rr. “****”, ap. ***, Tiranë, në emër të Ilir Proda.
- Deklaratë noteriale nr. ***, kol., datë 11.02.2017, ku shtetasi Y. C, pronar i kompanisë “****” sh.p.k., deklaron se në dhjetor të vitit 2014, ka lidhur një marrëveshje verbale me ndërtuesin O. C, administrator i firmës së ndërtimit “**** sh.p.k”, për porositjen e një apartamenti në vlerën 52, 000 euro (70 milion lekë të vjetra), adresa rr. “****”, Tiranë, afër shkollës “****”. Shumën do ta paguante me këste sipas ecurisë së punimeve. Këtë marrëveshje i’a ka bërë me dije mikut të tij Ilir Proda, i cili i ka kërkuar që këtë apartament ta blinte ai, por meqenëse Ilir Proda nuk ka pasur mundësi financiare, i ka kërkuar deklaruesit të bënte pagesën e kësteve dhe shuma në fjalë të njëjhej si borxh. Deklaruesi ka dashur t'a ndihmojë Ilir Prodën, pasi ka miqësi me të dhe babain e tij Agim Proda. Për këtë arsye i ka paguar këstet e apartamentit, ndërtuesit O. C, pavarësisht se kontrata e porosisë është lidhur midis ndërtuesit dhe Ilir Proda. Në momentin kur apartamenti është bërë gati për dorëzim, me anën e një shkrese nga ana e kompanisë, Y. C i ka njohur si borxh Ilir Prodës, shumën 52, 000 euro (70 milion lekë të vjetra), të paguar prej tij për apartamentin në fjalë. Me shtetasin Ilir Proda ka rënë dakord që borxhi në vlerën 52, 000 euro të shlyhet me këste çdo muaj 500 euro, sipas mundësive financiare, deri sa shuma të shlyhet plotësisht. Pasi është dorëzuar apartamenti, është lidhur kontrata midis ndërtuesit dhe Ilir Proda.

Procedura e vlerësimit:

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë kontrolli për asetin e mësipërm, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke analizuar të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion në funksion të hetimit administrativ, si dhe ka kryer verifikime në institucionet

përgjegjëse, të cilat kanë dërguar përgjigjet përkatëse në lidhje me deklaratimet apo mos deklarimet e subjektit të vlerësimit, e konkretisht:

ASHK, Drejtoria Vendore Tiranë Jug, me shkresën nr. ***, prot., datë 26.6.2023, konfirmon pasuri me nr. ***, vol. ***, fq. ***, Zk. ***, në emër të Ilir Proda.

Bashkëlidhur:

- Kontratë shitblerje e pasurisë së paluajtshme, nr. ***, datë 28.01.2017, me palë shitëse shoqëria “*** sh.p.k” dhe palë blerëse Ilir Proda, të apartamentit nr. ***, kt. ***, godina nr. ***, me numër pasurie ***, Zk. ***, vol. ***, fq. ***, me sipërfaqe banimi 119.8 m², në adresën rr. “***”, Tiranë, në vlerën 7, 000, 000 lekë, e likuiduar totalisht në arkën e shitësit, sipas mënyrës së përcaktuar në kontratën e porosisë datë 01.12.2014. Kalimi i pronësisë do të bëhet menjëherë pas nënshkrimit të kontratës.
- Kontratë sipërmarrje datë 01.12.2014, me investitor/ndërtues shoqëria “*** sh.p.k” dhe palë porositëse Ilir Proda, për apartament me sip. 119, 8 m² dhe sip. të hipotekueshme 130 m², në katin ***, në godinën ***, në adresën rr. “***”, Tiranë, në shumën 7, 000, 000 lekë. Pagesa do të bëhet me tre këste: kësti i parë paguhet me nënshkrimin e kontratës në vlerën 3, 000, 000 lekë, kësti i dytë do të jetë në janar 2015, në vlerën 2, 500, 000 lekë, kësti i tretë do të likuidohet në qershor 2016, në vlerën 1, 500, 000 lekë.
- Mandat pagesë nr. ***, datë 01.12.2014 nga Ilir Proda, të shumës 3, 000, 000 lekë, me përshkrimin “*Blerje ap. kt. ***, ap. ****”.
- Mandat pagesë nr. ***, datë 05.01.2015, nga Ilir Proda, të shumës 2, 500, 000 lekë, me përshkrimin “*Blerje ap. kt. ***, ap. ****”.
- Mandat pagesë nr. ***, datë 30.06.2016, nga Ilir Proda, të shumës 1, 500, 000 lekë, me përshkrimin “*Blerje ap. kt. ***, ap. ****”.
- Vërtetim datë 16.01.2017, nga dokumenti hipotekor në emër të shoqërisë “*** sh.p.k”.
- Ekstrakt historik në QKB, për shoqërinë “*** sh.p.k”.
- Vërtetim nga dokumenti hipotekor nr. ***, datë 08.02.2017, për pasurinë nr. ***, vol. ***, fq. ***, Zk. ***, apartament me sip. 119.8 m², në katin ***, në rr. “***”, Tiranë, në emër të Ilir Proda. Bashkëlidhur praktika e regjistrimit.

ISSH, me shkresën nr. ***, prot., datë 10.05.2023, konfirmon se Y. C ka përfituar të ardhura, pranë punëdhënësve Xhoi ***, “Star ***” sh.p.k, “Sara & Kristi” sh.p.k, për periudhën mars 2012 - mars 2023. Të ardhurat për periudhën mars 2012 - 30.06.2016, janë në vlerën 1, 072, 769 lekë.

Gjithashtu, shtetasja Majlinda Proda, ka përfituar të ardhura nga punësimi pranë punëdhënësve, Qendra Shëndetësore Sarandë, Shëndeti Publik Sarandë, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Sarandë, për periudhën janar 2012 - mars 2023. Të ardhurat neto nga punësimi për periudhën qershor 2012 - 31.12.2016, janë në vlerën rreth 1, 939, 308 lekë.

ISSH, me postën elektronike të datës 26.05.2023, ka bashkëlidhur tabelën përmbledhëse për të ardhurat nga punësimi të Agim Proda, pranë Ujësjiellës Kanalizime Sarandë sh.a., për periudhën janar 2012 - 30.12.2017. Agim Proda ka përfituar pension invaliditeti nga muaji gusht 2000 - dhjetor 2017, në vlerën 7, 572 lekë/muaj. Të ardhurat për periudhën qershor 2012 - 31.12.2016, janë në vlerën rreth 408, 888 lekë.

QKB, me shkresën nr. ***, prot., datë 08.05.2023, konfirmon se Y. C figuron të jetë i pajisur me NIPT L3*****K, në datën 25.10.2013, me status aktiv. Bashkëlidhur: Ekstrakt historik i subjektit “Star ***” sh.p.k, me NIPT L3*****K, regjistruar në datën 25.10.2013, me aktivitet “Konsulencë dhe shërbime në fushën imobiliare, analiza studime kërkime dhe kontrole si dhe hapjen e agjencive për këto shërbime. Import, eksport i produkteve ushqimore, makinerive dhe pajisjeve, produkte të ndërtimit etj.” Ortak i vetëm, Y. C, në 100% të aksioneve, me vlerë fillestare të kapitalit 100, 000 lekë.

Gjithashtu, Y. C është i pajisur me licencë nr. LN-***-04-***, për aktivitetin “Transport Rrugor Ndërkombëtar i Udhëtareve”, (me autobus) me status aktiv, të lëshuar nga QKB-ja. Bashkëlidhur, Licenca përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me shkresën nr. ***, prot., datë 11.05.2023, ka bashkëlidhur kopje të sistemit për shtetasin Y. C, ku figuron të jetë i regjistruar:

- Administrator/aksioner pranë subjektit “Star ***” sh.p.k, me NIPT L3*****K, pranë DRT Tiranë.
- Administrator pranë subjektit Y. C, me NIPT K3*****E, pranë DRT Durrës.

DRT Durrës, me shkresën nr. ***, prot., datë 29.05.2023, konfirmon se Y. C nuk rezulton i regjistruar si tatimpagues dhe nuk ka aktivitet të regjistruar pranë DRT Durrës.

DRT Tiranë, me shkresën nr. ***, prot. datë 26.05.2023, konfirmon se Y. C rezulton i regjistruar si aksioner, individ i kompanisë “Star ***” sh.p.k, me NIPT L3*****K, i regjistruar në sistemin tatimor në datë 25.10.2013, operator turistik me status ligjor sh.p.k. Xhiro dhe fitimi i deklaruar nga ky subjekt, sipas të dhënave të deklaratave të dorëzuara dhe të regjistruara në sistemin c@ts, janë si vijon:

Viti	Qarkullimi	Fitimi	Humbja	Fitimi pas tatimit
2013			73, 629	
2014	1, 880, 995	39, 908		33, 922
2015	9, 358, 296	2, 476, 76		2, 105, 430
2016	6, 808, 967	492, 117		418, 299
2017	19, 615, 358	9, 703, 197		8, 247, 717
2018	25, 388, 959	3, 468, 659		2, 948, 360
2019	24, 473, 839	2, 612, 166		2, 220, 341
2020	14, 756, 985		2, 937, 924	
2021	18, 643, 204	948, 524		806, 245
2022	34, 343, 924	12, 637, 108		10, 741, 542

Ky subjekt nuk ka shpërndarë dividend. Për vitin 2022 nuk është dorëzuar vendimi i ortakut. Nuk ka detyrime të papaguara.

Në procesverbalin e datës 05.10.2023, subjekti sqaroi se shtetasi Y. C, ka aktivitete të ndryshme private dhe ka pasur mundësi financiare për të kryer pagesat e kësteve të apartamentit. Ky shtetas ka aktivitet privat si operator turistik, ortak i vetëm i kompanisë “Star ***” sh.p.k, me NIPT L3*****K, nga viti 2013, me qarkullime në vlera të konsiderueshme ndër vite. Gjithashtu, ka

licencë për aktivitet “transporti rrugor ndërkombëtar i udhëtareve (me autobus)”, e lidhur me aktivitetin si operator turistik.

Përveç sa sipër, në lidhje me burimin financiar të pagesës së kësteve të apartamentit, subjekti vuri në dispozicion dokumentacion për shitjen e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, nga shtetasi Y. C, dokumentacion për të ardhurat e prindërve, deklaratë të administratorit të shoqërisë “**** sh.p.k”, datë 06.06.2023 dhe kontratë sipërmarrje datë 01.12.2014, me investitor/ndërtues shoqëria “**** sh.p.k”.

Subjekti i vlerësimit sqaroi se, pavarësisht se kontrata e porosisë është nënshkruar prej tij, pagesat e kësteve referuar kësaj kontrate janë paguar nga Y. C, me burim të ardhurat e këtij të fundit.

Në lidhje me mobilimin e shtëpisë, nuk disponon fatura për shkak të kohës së largët. Për arredimin në vlerën 1, 000, 000 lekë, sqaroi se babai e ka ndihmuar me gjysmën e kësaj vlere, me burim nga kursimet e prindërve, ndërsa pjesa tjetër është mbuluar nga kursimet e tij.

Sa i përket huamarrjes në shumën 52, 000 euro, subjekti deklaroi se ka paguar detyrimet prej 22, 000 euro cash kundrejt shtetasit Y. C, referuar dhe deklaratave noteriale me burim kursimet familjare.

Gjithashtu në deklaratën e pasurisë për vlerësimin kalimtar, subjekti i vlerësimit Z. Ilir Proda, në seksionin: “Adresa e plotë”, ku është regjistruar në gjendjen civile, ka deklaruar adresën: Njësia Administrative nr. 7, rr. ****, Pallati ***, Apartamenti ****.

Në lidhje me adresën e deklaruar, subjekti ka sqaruar se është i njëjti apartament i deklaruar me lart, për të cilën ka dorëzuar certifikatën personale, certifikatën për vërtetim pronësie, si dhe vërtetimin nga dokumenti hipotekor nr. ***, datë 08.02.2017, pasuria nr. ***, vol. ***, fq.***, Zk. ***, e llojit apartament, me sip. 119,8 m², në rr. “****”, Tiranë.

Subjekti u shpreh se ndryshimi në numrin e apartamentit të pallatit etj., mund të ndodhi për shkak të adresarit të ri të adresave.

Sa më sipër subjekti paraqiti:

- Deklaratë, datë 06.06.2023, nga shtetasi O. C, administrator i shoqërisë “**** sh.p.k”, i cili deklaroi se, në vitin 2014, shoqëria ka qenë në proces ndërtimi të një pallati ****- katësh në rr. “****” Tiranë. Në momentet e para të ndërtimit, shtetasi Y. C ka shprehur interes për të porositur një apartament në pallatin që po ndërtohej, dhe kanë rënë dakord verbalisht që për shumën 7, 000, 000 lekë, të porosisë një apartament në katin e ****-të. Në momentin kur do të lidhnin kontratën e sipërmarrjes, shtetasi Y. C, i ka kërkuar që kontrata të lidhej midis tij dhe shtetasit Ilir Proda i cili do të ishte përfituesi i këtij apartamenti, sipas dakordësisë që Y.C kishte me Ilirin. Ndodhur përpara këtij fakti, deklaruesi ka rënë dakord dhe kontratën e sipërmarrjes datë 01.12.2014 e ka lidhur me shtetasin Ilir Proda dhe shlyerja e kësteve është kryer në mënyrën e vendosur me shtetasin Y. C, duke u paguar nga ky i fundit për llogari të përftuesit Ilir Proda. Në përfundim të ndërtimit të pallatit në vitin 2017, pas shlyerjes të kështit të fundit të pagesës, ka lidhur kontratën e shitjes me shtetasin Ilir Proda, konkretisht kontrata nr. ***, datë 28.01.2017. Për efekt lehtësi dokumentacioni me shtetasin Y. C, nuk ka nënshkruar kontratë apo dokument tjetër, por i është përmbajtur marrëveshjes paraprake që kishte me të.

- Kontratë sipërmarrje, datë 01.12.2014, me investitor/ndërtues shoqëria “**** sh.p.k” dhe palë porositëse Ilir Proda, për apartament me sip. 119.8 m² dhe sip. të hipotekueshme 130 m², në katin e pestë në godinën ***- katëshe, në adresën rr. “****”, Tiranë, në shumën 7, 000, 000 lekë. Paguesa do të bëhet me tre këste, kësti i parë paguhet me nënshkrimin e kontratës në vlerën 3, 000, 000 lekë, kësti i dytë do të jetë në janar 2015 në vlerën 2, 500, 000 lekë, kësti i tretë do të likuidohet në qershor 2016, në vlerën 1, 500, 000 lekë.
- Mandat pagesë nr. ***, datë 01.12.2014, nga Ilir Proda, të shumës 3, 000, 000 lekë, me përshkrimin “Blerje ap. kt. *-të, ap.***”.
- Mandat pagesë nr. ***, datë 05.01.2015, nga Ilir Proda, të shumës 2, 500, 000 lekë, me përshkrimin “Blerje ap. kt. ***-të, ap. ***”.
- Nxjerrje llogari bankare datë 31.05.2023, në Union Bank, në emër të Agim Proda, në të cilën i është kredituar paga nga F.SH.F, për periudhën 30.10.2012 - 31.12.2016, në vlerën rreth 230, 000 lekë.
- Vërtetim nr. ***, prot., datë 02.06.2023, nga Federata Shqiptare e Futbollit, që vërteton se shtetasi Agim Proda ka përfituar të ardhura, si vëzhgues gjyqtarësh për periudhën 2011 - 2017. Agim Proda ka marrë pjesë si vëzhgues në 56 ndeshje dhe është paguar nga institucioni në masën 8, 000 lekë për ndeshje.
- Vërtetim nr. ***, prot., datë 30.05.2023, nga Ujësjellësi Kanalizime Sarandë, që konfirmon se Agim Proda ka përfituar të ardhura nga paga për periudhën qershor 2012 - 31.12.2016, në shumën 1, 515, 595 lekë.
- Vërtetim nr. ***, prot., datë 30.05.2023, nga Qendra Shëndetësore Sarandë, që vërteton se shtetasja Majlinda Proda ka realizuar të ardhura bruto për periudhën janar 2012 - 30.04.2023.
- Kontratë shitblerje pasuri e luajtshme, automjeti nr. ***, datë 03.01.2013, me palë shitëse Y. C dhe palë blerëse K. K, të mjetit autobus, me targa TR ****T, në vlerën 1, 500, 000 lekë.
- Kontratë shitblerje pasuri e luajtshme automjeti, nr. ***, datë 03.01.2013, me palë shitëse Y. C dhe palë blerëse K. K, të mjetit autobus, me targa TR ****U, në vlerën 1, 500, 000 lekë.
- Kontratë shitje pasurie e luajtshme, nr. ***, datë 04.07.2016, me palë shitëse Y. C dhe palë blerëse G. Xh, të mjetit me targa AA *** AP, në vlerën 960, 000 lekë.
- Kontratë shitje automjeti, nr. ***, datë 01.04.2014, me palë shitëse Y. C dhe palë blerëse J. S, të mjetit me targa AA *** IZ, në vlerën 7, 000 euro.
- Kontratë shitblerje pasuri e luajtshme, nr. ***, datë 26.04.2014, me palë shitëse Y. C dhe palë blerëse shoqëria “Star ***”, të mjetit me targa AA *** FY, në vlerën 4, 000 euro.
- Kontratë shitje automjeti, nr. ***, datë 03.04.2013, me palë shitëse Y. C dhe palë blerëse I. P, të mjetit me targa AA *** FZ, në vlerën 500, 000 lekë.
- Kontratë shitje automjeti, nr. ***, datë 19.09.2013, me palë shitëse Y. C dhe palë blerëse G. K, të mjetit me targa AA *** GJ, në vlerën 500, 000 lekë.
- Kontratë shitblerje pasuri e luajtshme, nr. ***, datë 15.11.2016, me palë shitëse Y. C dhe palë blerëse M. A, të mjetit me targa AA *** ON, në vlerën 900, 000 lekë.
- Kontratë shitje automjeti, nr. ***, datë 21.11.2016, me palë shitëse Y. C dhe palë blerëse S. D, të mjetit me targa AA *** MP, në vlerën 400, 000 lekë.
- Kontratë shitblerje pasuri e paluajtshme, njësi tregtare, nr. ***, datë 10.04.2013, me palë shitëse Y. C dhe palë blerëse L. S, të njësisë me sipërfaqe 42.4 m², në adresën Yzberisht, në katin përdhës të godinës së ndërtuar nga shoqëria “****” sh.p.k., me nr. pasurie ***, vol., ***,

fq. *** në Zk. ***, në vlerën 5, 000, 000 lekë. Certifikatë për vërtetim pronësie dhe kartelë e pasurisë së paluajtshme të njësisë me sipërfaqe 42.4 m², në emër të Y. C.

- Certifikatë familjare datë 16.02.2023, të Ilir Proda, regjistruar në Njësinë Administrative nr. 7, Tiranë.
- Certifikatë personale datë 06.03.2023, të Ilir Proda, regjistruar në Njësinë Administrative nr. 7, Tiranë, me vendbanim në adresën rr. “****”; Nd. ***, H. ***, Ap. ***, Tiranë, Njësia Bashkiake nr. 7, 1023, Tiranë”.
- Kopje të pasaportave të fëmijëve Isel dhe Kristi Proda.

Trupa e Vlerësimit ka administruar dokumentacionin justifikues ligjor mbi të ardhurat e personave të lidhur me subjektin e vlerësimit, gjithashtu ka kryer analizën financiare përkatëse për të justifikuar mundësinë e kursimit të vlerës prej 500, 000 lekë të përdorur nga subjekti i vlerësimit, me qëllim arredimin e apartamentit. (Aneksi 1).

Konkluzion:

Bazuar në deklarinë e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga Trupa e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur rezultojnë se:

- *Apartamenti me sip. 119.8 m², në rr. “****” në Tiranë, është përfituar me kontratë sipërmarrje në muajin dhjetor 2014 dhe kontratë blerje në muajin janar 2017, me burim hua në vlerën 52, 000 euro, nga shtetasi Y. C.*
- *Për burimin financiar të shumës 52, 000 euro të shtetasit Y. C, subjekti ka paraqitur dokumentacion justifikues lidhur me të ardhurat e këtij shtetasi nga pagat, shitja e automjeteve dhe shitja e njësisë në Yzberisht, Tiranë, gjatë periudhës 2012 - qershor 2016.*
- *Lidhur me mobilimin e këtij apartamenti, subjekti ka deklaruar shpenzime në shumën 1, 000, 000 lekë, me burim rreth 500, 000 lekë nga kursimet familjare të tij dhe pjesa tjetër kontribut nga babai.*
- *Referuar analizës financiare, rezultojnë se subjekti i vlerësimit ka patur të ardhura të mjaftueshme me qëllim kursimin e vlerës prej 500, 000 lekë për arredimin e këtij apartamenti.*
- *Personat e lidhur me subjektin, referuar dokumentacionit të administruar, rezultojnë se kanë patur të ardhura të ligjshme me qëllim justifikimin e vlerës prej 500, 000 lekë dhënë subjektit për arredimin e apartamentit.*
- *ASHK konfirmon apartamentin e regjistruar në emër të Ilir Proda.*
- *Subjekti ka dhënë sqarime në lidhje me adresën e deklaruar.*

3. Gjendje në llogarinë rrjedhëse me nr. ***, gjendje aktuale 519, 670 lekë, nga të cilat 150, 000 lekë overdraft, ndërsa 369, 670 lekë, kursime. Zotërimi 100 %.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Ndryshim në kontratën e kredisë me kufi (overdraft), të datës 20.10.2005, e lidhur midis Raiffeisen Bank dhe Ilir Proda, më datë 16.08.2013, ku shuma e kredisë e akorduar do të jetë deri në vlerën 150, 000 lekë.
- Vërtetim nr. ***, prot., datë 19.04.2018, nga Raiffeisen Bank, mbi produktet bankare të klientit, Ilir Proda.

- Nxjerrje llogari bankare pranë Raiffeisen Bank, në emër të Ilir Proda, për periudhën 19.04.2018 - 14.02.2023.

Procedura e vlerësimit:

Raiffeisen Bank, me shkresën nr. ***, prot., datë 08.05.2023, konfirmon se Ilir Proda ka llogari page me gjendje 419, 670 lekë, në datën 09.03.2023, ka overdraft me limit 150, 000 lekë.

Në procesverbalin e datës 05.10.2023, subjekti konfirmon përgjigjen e Raiffeisen Bank për vlerën 419, 670 lekë dhe shtoi se ka overdraftin në shumën 150, 000 lekë të papërdorur.

Trupa e Vlerësimit me qëllim vlerësimin e ligjshmërisë së të ardhurave financiare si dhe vlerësimin e mundësisë për kursimin e vlerës prej 419, 670 lekë, kreu analizën financiare përkatëse e cila ndodhet bashkëlidhur këtij relacioni (Aneksi 1).

Konkluzion:

Bazuar në deklarinimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga Trupa e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur rezulton se:

- *Deklarimi i subjektit të vlerësimit, përputhet me përgjigjet e institucioneve bankare.*
- *Subjekti i vlerësimit, referuar analizës financiare, ka patur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme, me qëllim kursimin e shumës prej 419, 670 lekë deri në datë 09.03.2023.*

4. Investim në kriptomonedha janar 2023, shuma fillestare e investuar 1, 000 euro, portofoli Binance, me user id. ***, kriptomonedha ***, gjendja aktuale në momentin e plotësimit 1, 344 euro. Zotërimi 100%.

Procedura e vlerësimit:

Në procesverbalin e datës 05.10.2023, subjekti paraqiti dokumentacion në gjuhën angleze, në lidhje me investimin në kriptomonedha “****”, me balance 980.14 euro dhe sqaroi se vlera ndryshon për shkak të lëvizjeve në bursë.

Konkluzion:

- *Subjekti ka dhënë sqarime dhe ka paraqitur dokumentacion në lidhje me kriptomonedhën e deklaruar.*
- *Subjekti i vlerësimit, referuar analizës financiare (Aneksi 1), ka patur të ardhura të mjaftueshme me qëllim kursimin e vlerës prej 1, 000 Euro në janar 2023.*

5. Automjet Renault Skenik, vit prodhimi 2001, blerë në datë 24.01.2012, shuma 3, 500 euro, shitur në datë 07.03.2015, shuma 1, 000 euro. Burimi krijimit: a) Kursime.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitje automjeti, nr. ***, datë 24.01.2012, me palë shitëse I. K dhe palë blerëse Ilir Proda të automjetit tip Renault Megane, vit prodhimi 2001, me targa BP *** KC, në vlerën 3, 500 euro.
- Kontratë shitblerje automjeti, nr. ***, datë 07.03.2015, me palë shitëse Ilir Proda dhe palë blerëse A. B, të automjetit tip Renault Megane, me targa AA *** CU, në vlerën 1, 000 euro.

Procedura e vlerësimit:

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë kontrolli për asetin e mësipërm, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke analizuar të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion në funksion të hetimit administrativ, si dhe ka kryer verifikime në institucionet përgjegjëse, të cilat kanë dërguar përgjigjet përkatëse në lidhje me deklaratimet apo mos deklaratimet e subjektit të vlerësimit, e konkretisht:

DPSHTRR, me shkresën nr. ***, prot., datë 15.05.2023, konfirmon se Ilir Proda ka pasur në pronësi automjetin me targa AA *** LK (AA *** CU). Bashkëlidhur:

- Kontratë shitje automjeti, nr. ***, datë 24.01.2012, ne palë shitëse I. K dhe palë blerëse Ilir Proda, të automjetit tip Renault Megane, vit prodhimi 2001, me targa BP *** KC, në vlerën 3, 500 euro.
- Kontratë shitblerje automjeti, nr. ***, datë 07.03.2015, me palë shitëse Ilir Proda dhe palë blerëse A. B, të automjetit tip Renault Megane, me targa AA *** CU, në vlerën 1, 000 euro.

Trupa e Vlerësimit ka analizuar të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion në funksion të hetimit administrativ, nga ku është konstatuar se, në kontratën e shitblerjes me nr. ***, datë 24.01.2012, me palë shitëse I. K dhe palë blerëse Ilir Proda, bëhet fjalë për automjetin tip Renault Megane dhe jo për automjetin Renault Scenik të deklaruar nga subjekti i vlerësimit.

Sa më sipër subjekti i vlerësimit sqaron se bëhet fjalë për të njëjtën automjet që ka deklaruar në deklaratën e pasurisë. Në kontratën noteriale të përmendur më lart nuk është bërë përshkrimi i plotë i automjetit nga noteri, pasi përshkrimi i saktë do të ishte Renault Scenik Megane pasi dhe po të kërkosh në google përshkrimi i këtij automjeti në manualët e kompanisë është Renault Scenik Megane.

Bashkëlidhur sqarimeve, subjekti i vlerësimit ka vënë në dispozicion një foto të printuar nga kërkimi në google për këtë lloj automjeti.

Nga verifikimi i llogarisë bankare të subjektit të vlerësimit pranë Raiffeisen Bank, me nr. llogarie ***, konstatohet se më datë 24.01.2012 është debituar shuma 100, 000 lekë, për të cilën subjekti i vlerësimit sqaron se janë tërhequr me qëllim blerjen e këtij automjeti.

Me qëllim vlerësimin e ligjshmërisë së të ardhurave financiare si dhe vlerësimin e mundësisë për kursimin e vlerës prej 3, 500 euro më datë 24.01.2012, Trupa e Vlerësimit kreu analizën financiare përkatëse e cila ndodhet bashkëlidhur këtij relacioni (Aneksi 1).

Konkluzion:

Bazuar në deklarinimin e subjektit të vlerësimit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga Trupa e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur rezulton se:

- ***Deklarimi përputhet me dokumentacionin e paraqitur nga DPSHTRR dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i vlerësimit.***
- ***Subjekti i vlerësimit, ka patur të ardhura të ligjshme dhe të mjaftueshme me qëllim justifikimin e blerjes së automjetit në vitin 2012.***

6. Automjet Mercedes Benz C200, vit prodhimi 2001, blerë në datën 25.11.2014, shuma 200, 000 lekë, shitur në datë 19.08.2021, shuma 200, 000 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitje automjeti, nr. ***, datë 25.11.2014, me palë shitëse M. L dhe palë blerëse Ilir Proda, të mjetit tip Mercedes Benz, me targa TR ***L, në vlerën 200, 000 lekë, likuiduar.
- Kontratë shitje pasurie e luajtshme, nr. ***, datë 19.08.2021, me palë shitëse Ilir Proda dhe palë blerëse S. B, të automjetit tip Mercedes Benz, me targa AA *** KS, në vlerën 200, 000 lekë.

Procedura e vlerësimit:

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë kontrolli për asetit e mësipërm, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke analizuar të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion në funksion të hetimit administrativ, si dhe ka kryer verifikime në institucionet përgjegjëse, të cilat kanë dërguar përgjigjet përkatëse në lidhje me deklaratimet apo mos deklaratimet e subjektit të vlerësimit, e konkretisht:

DPSHTRR, me shkresën nr. ***, prot., datë 15.05.2023, konfirmon se Ilir Proda ka pasur në pronësi automjetin me targa AB *** HP (AA *** KS). Bashkëlidhur: Dosje e automjetit, konkretisht:

- Kontratë shitje automjeti, nr. ***, datë 25.11.2014, me palë shitëse M. L dhe palë blerëse I. P, të automjetit tip Mercedes Benz, me targa TR ***L, në vlerën 200, 000 lekë, likuiduar.

DPSHTRR, me postën elektronike të datës 19.07.2023, ka bashkëlidhur dosjen e plotë të automjetit me targa AA *** KS.

- Kontratë shitje pasuri e luajtshme, nr. ***, datë 19.08.2021, me palë shitëse Ilir Proda dhe palë blerëse S. B, të automjetit tip Mercedes Benz, me targa AA *** KS, në vlerën 200, 000 lekë. Bashkëlidhur: Praktika e automjetit dhe kopje e kartave ID respektive.

Trupa e vlerësimit lidhur me shitblerjen e këtij automjeti, ka konstatuar se subjekti i vlerësimit e ka shitur me të njëjtën çmim (200, 000 lekë), pas 7 vite përdorim.

Lidhur me këtë fakt, subjekti i vlerësimit ka sqaruar se: *“...Automjeti Mercedes Benz C200, është blerë me defekt në motor, për riparimin e të cilit e ka ndihmuar babai i tij Agim Proda, duke qenë se në profesion ka qenë mekanik. Për kohën kur është blerë automjeti në fjalë, çmimi i blerjes së automjetit ka qenë më i ulët se vlera e tregut, pasi nëse ky automjet do të blihej në gjendje optimale me këtë vit prodhimi, në vitin 2014 do të kushtonte pak a shumë rreth 500, 000 – 600, 000 lekë. Vlera e shitjes së këtij automjeti në vitin 2021, është e përafërt me vlerën e tregut për një automjet të shitur 20 vite pas prodhimit të tij për shkak të amortizimit...”*

Me qëllim vlerësimin e ligjshmërisë së të ardhurave financiare si dhe mundësisë për kursimin e vlerës prej 200, 000 lekë më datë 25.11.2014, Trupa e Vlerësimit kreu analizën financiare përkatëse e cila ndodhet bashkëlidhur këtij relacioni (Aneksi 1).

Konkluzion:

Bazuar në deklarinimin e subjektit të vlerësimit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga Trupa e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur rezultojnë se:

- *Deklarimi përputhet me dokumentacionin e paraqitur nga DPSHTRR dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i vlerësimit.*
- *Subjekti i vlerësimit, ka patur të ardhura të ligjshme dhe të mjaftueshme me qëllim justifikimin e blerjes së automjetit në vitin 2014.*

7. Automjet Peugeot 3008, vit prodhimi 2010, blerë në datën 15.01.2016, shuma 1, 500 euro shtuar shuma 211, 459 lekë dogana, gjithsej sipas kursit të kohës rreth 402, 000 lekë. Shitur në datë 19.08.2021 në shumën 3, 000 euro. Burimi krijimit: a) Kursime nga shitja e secilit automjet.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Certifikatë e shitjes së automjetit, me palë shitëse S. B, i cili deklaron se në datë 15. 01.2016, i ka shitur palës blerëse Ilir Proda, automjetin tip Peugeot 3008, me targa AN-***-MN.
- Dokument në gjuhën franceze, deklaratë doganore, datë 30.01.2017, për zhdoganimin e automjetit në vlerën 211, 459 lekë, me eksportues S. B dhe marrës Ilir Proda.
- Kontratë shitblerje nr. ***, datë 02.11.2017, me palë shitëse Ilir Proda dhe palë blerëse Gj. K, të automjetit tip Peugeot 3008, me targa AA *** PS, në vlerën 3, 000 euro.

Procedura e vlerësimit:

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë kontrolli për asetimin e mësipërm, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke analizuar të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion në funksion të hetimit administrativ, si dhe ka kryer verifikime në institucionet përgjegjëse, të cilat kanë dërguar përgjigjet përkatëse në lidhje me deklarinimet apo mos deklarinimet e subjektit të vlerësimit, e konkretisht:

DPSHTRR, me shkresën nr. ***, prot., datë 15.05.2023, konfirmon se Ilir Proda ka pasur në pronësi automjetin me targa AB *** GO (AA *** PS). Bashkëlidhur:

- Kontratë shitblerje nr. ***, datë 02.11.2017, me palë shitëse Ilir Proda dhe palë blerëse Gj. K, të automjetit tip Peugeot 3008, me targa AA *** PS, në vlerën 3, 000 euro.
- Deklaratë doganore, datë 30.01.2017, për zhdoganimin e automjetit në vlerën 211, 459 lekë, me eksportues S. B dhe marrës Ilir Proda.

DPSHTRR, me postën elektronike të datës 19.07.2023, ka bashkëlidhur dosjen e plotë të mjetit me targa AB *** GO (AA *** PS).

- Kontratë shitblerje nr. ***, datë 02.11.2017, me palë shitëse Ilir Proda dhe palë blerëse Gj. K, të automjetit tip Peugeot 3008, me targa AA *** PS, në vlerën 3, 000 euro.
- Certifikatë e shitjes së automjetit, me palë shitëse S. B, i cili deklaron se në datë 15.01.2016 i ka shitur palës blerëse Ilir Proda, automjetin tip Peugeot 3008, me targa AN-***-MN.

- Dokument në gjuhën franceze, deklaratë doganore datë 30.01.2017, për zhdoganimin e automjetit në vlerën 211, 459 lekë, me eksportues S. B dhe marrës Ilir Proda. Bashkëlidhur praktika e automjetit.

Në procesverbalin e datës 05.10.2023, subjekti saktësoi se data e shitjes së automjetit është 02.11.2017, sipas kontratës. Subjekti saktësoi se i ka paguar palës shitëse, vlerën prej 1, 500 euro, e cila nuk figuron në dokument për shkak të rregullave në shtetin francez, ku nuk është e detyrueshme vendosja e vlerës së sendeve të luajtshme. Dokument tjetër nuk disponon.

Gjithashtu subjekti i vlerësimit ka dhënë shpjegime pranë Trupës së Vlerësimit, lidhur me burimin e krijimit të të ardhurave me qëllim blerjen e këtij aseti, ku sqaroi se janë të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit tip Renault Scenic Megane, në datë 07.03.2015 si dhe kursime nga të ardhurat familjare.

Me qëllim vlerësimin e ligjshmërisë së të ardhurave financiare si dhe vlerësimin e mundësisë për kursimin e vlerës prej 402, 000 lekë, më datë 15.01.2016, Trupa e Vlerësimit kreu analizën financiare përkatëse e cila ndodhet bashkëlidhur këtij relacioni (Aneksi 1).

Konkluzion:

Bazuar në deklarinimin e subjektit të vlerësimit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga Trupa e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur rezulton se:

- ***Deklarimi i subjektit të vlerësimit lidhur me periudhën e shitjes së automjetit tip Peugeot 3008, nuk përputhet me dokumentacionin e paraqitur nga DPSHTRR.***
- ***Lidhur me këtë fakt, subjekti i vlerësimit ka dhënë shpjegimet përkatëse duke konfirmuar të dhënat e vëna në dispozicion nga DPSHTRR, të cilat janë marrë në konsideratë nga Trupa e Vlerësimit.***
- ***Subjekti i vlerësimit dha shpjegime lidhur me burimin e krijimit të të ardhurave me qëllim blerjen e asetit të mësipërm.***
- ***Subjekti i vlerësimit, ka patur të ardhura të ligjshme dhe të mjaftueshme me qëllim justifikimin e blerjes së automjetit në vitin 2016.***

Pasuria nr. 8: Ortak në masën 50%, në shoqërinë “Sara & Kristi” sh.p.k, themeluar në datë 15.05.2017, me aktivitet ekonomik, dhënia me qira e automjeteve. Shuma e investuar 100, 000 lekë, si dhe kam vënë në dispozicion të firmës automjetin AA *** KS. Vlera 200, 000 lekë; automjetin me targa AA *** PS, vlera 402, 000 lekë, si dhe investuar shumën monetare 100, 000 lekë. Mbyllur aktiviteti në datën 06.12.2018. Zotërimi 50%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Statuti i shoqërisë “Sara & Kristi” sh.p.k, datë 15.05.2017, me ortakët Y. C dhe Ilir Proda, të cilët krijuan shoqërinë me aktivitet ekonomik, në fushën e dhënies me qira të automjeteve. Kapitali fillestar është në shumën 50, 000 lekë, investuar 50% nga secili ortak, me vlerë 25, 000 lekë.
- Formular i deklarinimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për subjektin “Sara & Kristi” sh.p.k, me NIPT L7*****E, për vitin 2017, ku të ardhurat janë në vlerën 875, 011 lekë, ndërsa shpenzimet janë në vlerën 573, 309 lekë, fitimi në vlerën 301, 702 lekë.

Procedura e vlerësimit:

Qendra Kombëtare e Biznesit, me shkresën nr. ***, prot., datë 08.05.2023, konfirmon se shtetasit Ilir Proda dhe Y. C figurojnë të jenë bashkë aksioner në subjektin tregtar “Sara & Kristi” sh.p.k., me NIPT L7*****E, regjistruar në datë 19.05.2017. Statusi i subjektit “shoqëri në likuidim e sipër”.

Bashkëlidhur: Ekstrakt historik i subjektit “Sara & Kristi” sh.p.k., me NIPT L7*****E, regjistruar në datën 19.05.2017, me aktivitet ekonomik në fushën e dhënies së automjeteve me qira. Shtetasit Ilir Proda dhe Y. C, janë aksionerët të cilët zotërojnë 50% të aksioneve secili, me kapital fillestar në shumën 25, 000 lekë/secili. Y. C është larguar si administrator nga shoqëria në datën 06.12.2018, dhe është shtuar likuiduesi E. T, pasi shoqëria ka kaluar në status “shoqëri në likuidim e sipër”. Këto ndryshime janë pasqyruar në QKB në datën 07.12.2018.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me shkresën nr. ***, prot., datë 11.05.2023, ka bashkëlidhur kopje të sistemit për shtetasit Ilir Proda dhe Y. C, ku figurojnë të jenë të regjistruar si aksioner, në subjektin “Sara & Kristi sh.p.k”, me NIPT L7*****E, pranë DRT Tiranë.

Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, me shkresat nr. ***, prot., datë 05.05.2023 dhe nr. ***, prot., datë 26.05.2023, konfirmojnë se Ilir Proda dhe Y. C, figurojnë të jenë të regjistruar si aksioner pranë subjektit “Sara & Kristi” sh.p.k., në datë 19.05.2017. Xhiro e realizuar nga ky subjekt është si më poshtë shënuar:

- Viti 2017, qarkullimi 875, 011 lekë, fitimi 301, 702 lekë, fitimi pas tatimit 301, 702 lekë.
- Viti 2018, qarkullimi 179, 797 lekë, humbja 617, 365 lekë.
- Viti 2019, qarkullimi 1, 799, 790 lekë, humbja 14, 000 lekë.
- Viti 2020: s'ka të dhëna.

Ky subjekt nuk ka detyrime të papaguara. Nuk ka shpërndarë dividend. Aktualisht, ky subjekt rezulton me status “kërkesë për ç ’regjistrim nga data 31.01.2020”.

Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, me postën elektronike të datës 26.05.2023, konfirmon se për subjektin “Sara & Kristi” sh.p.k, Ilir Proda dhe Y. C janë aksionerë me nga 50% secili. Në sistemin tatimor c@ts, rezulton me status “kërkesë për ç ’regjistrim”, nga data 31.01.2020.

Në procesverbalin e datës 05.10.2023, subjekti u pyet në lidhje me deklarimin dhe konfirmimet nga QKB dhe DRT Tiranë, ku sqaroi se ka deklaruar regjistrimin e 50% të aksioneve pranë subjektit “Sara & Kristi” sh.p.k., ku për vitin 2017 janë realizuar të ardhura/fitim në shumën 301, 702 lekë, nga të cilat, pjesa takuese e 50% është llogaritur rreth 150, 851 lekë. Ka deklaruar se shoqëria ka pushuar së funksionuari më datë 06.12.2018, pasi dhe shtetasi Y. C është larguar nga detyra e administratorit, referuar kjo dhe me ndryshimet e bëra në QKB, meqenëse shoqëria ka kaluar në likuidim e sipër. Veprimet pas kësaj date, janë kryer nga likuiduesi E. T, në dijeninë e tij. Gjatë vitit 2018 - 2019, kjo shoqëri ka dalë me humbje dhe nuk janë përfutur të ardhura/fitim. Referuar DRT Tiranë, sqaroi se veprimet e fundit të shoqërisë për ç ’regjistrim janë kryer në datën 31.01.2020.

Sipas statutit të shoqërisë “Sara & Kristi” sh.p.k, datë 15.05.2017, subjekti sqaroi se shuma e investuar nga ai në aksione, është 25, 000 lekë.

Gjithashtu më datë 24.11.2023, subjekti i vlerësimit ka dhënë shpjegime shtesë lidhur me këtë shoqëri, ku sqaron se ka qenë ortak në subjektin “Sara & Kristi” sh.p.k., deri në nëntor 2018. Për shkak të angazhimeve, llojit të aktivitetit si dhe mungesa e kohës fizike për t’ju përkushtuar këtij aktiviteti, ka shkëputur marrëdhëniet me subjektin në fillim të dhjetorit 2018. Më datë 04.12.2018, ka vendosur të largohet nga ortakëria dhe ka rënë dakord me administratorin që të paguhet me 50 % të fitimit të realizuar deri në atë moment, konkretisht në shumën rreth 150, 850 lekë, shumë e cila është paguar cash nga administratori. Vlera që i takonte të merrte, ka qenë 175, 000 lekë dhe diferenca e mbajtur nga ortaku do të shërbente për të paguar detyrimin e tatimit në burim në momentin që do të shpërndahej dividendi, (për vitin 2017 kanë vendosur të mos shpërndajnë dividend dhe shpërndarja të bëhej në vitet e ardhshme). Pasi ka marrë këtë vlerë monetare, ka hequr dorë nga të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lindnin nga ortakëria në këtë subjekt. Në lidhje me pagesën e dividendit, subjekti i vlerësimit shprehet se ka qenë përgjegjësi e administratorit pasi ai pas shkëputjes ka marrë përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet në lidhje me shoqërinë. Shoqëria nuk ka patur llogari bankare.

Bashkëlidhur sqarimeve, subjekti i vlerësimit paraqiti kopje të vendimit të administratorit mbi heqjen dorë nga ortakëria.

Konkluzion:

Bazuar në deklarinimin e subjektit të vlerësimit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga Trupa e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur rezulton se subjekti i vlerësimit:

- *Ka dhënë sqarime në lidhje me deklarinimin dhe konfirmimet e institucioneve tatimore.*
- *Ka qenë ortak në këtë shoqëri nga data 15.05.2017 deri më datë 04.12.2018, dhe në cilësinë e investitorit ka marrë shumën prej 150, 850 lekë, paguar cash nga administratori.*
- *Ka investuar fillimisht në aksione vlerën 25, 000 lekë, sipas statutit të shoqërisë “Sara & Kristi” sh.p.k, datë 15.05.2017.*
- *Ka patur të ardhura të ligjshme dhe të mjaftueshme me qëllim justifikimin e investimit të shumës prej 25, 000 lekë në shoqërinë “Sara & Kristi” sh.p.k.*

Deklarimi i të ardhurave financiare ndër vite të subjektit të vlerësimit

Në mbështetje të nenit 33, pika 1/b, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, subjekti i cili i nënshtrohet vlerësimit, deklaron të ardhurat nga paga, nga angazhime në veprimtari private dhe/ose publike, me qëllim fitimi dhe çdo lloj veprimtarie të kryer brenda dhe jashtë vendit, që ka krijuar të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, licenca dhe patenta, që sjellin fitim, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe pjesëmarrje në çdo organizatë tjetër të subjektit të vlerësimit dhe personave të lidhur me të, për periudhën nga momenti i fillimit të detyrës deri në datën e dorëzimit të formularit të deklaratës së pasurisë.

Sa më sipër subjekti i vlerësimit ka deklaruar:

- ❖ Të ardhura nga paga, shpërblime, pagesë për largësi nga vendbanimi dhe pagesë për veshje, në funksione të ndryshme të Policisë së Shtetit, nga data 19.08.2005 deri në 19.4.2018. Totali 9,

989, 069 lekë. Këto të ardhura pasqyrohen në llogari rrjedhëse nr. 0100551267, gjendja aktuale e llogarisë 619, 670 lekë, nga të cilat, gjendje overdraft 150, 000 lekë, ndërsa shuma 469, 670 lekë, kursime. Shuma 9, 989, 069 lekë.

- ❖ Të ardhura nga paga, dieta, shpërblime, pagesë për largësi nga vendbanimi dhe pagesë për veshje, në funksione të ndryshme të Policisë së Shtetit, nga data 19.04.2018, deri në 01.02.2023. Totali 5, 558, 218 lekë.
- ❖ Të ardhura nga dhënia me qira e apartamentit me sip. 52,9 m², me adresë rr. “****”, pll. ***, ap. ***, lëshuar me qira në datë 01.10.2017, rinovuar çdo vit në afat deri në shtator 2023. Qiramarrës P. C, me nr. ID J*****P, kësti mujor 20, 000 lekë, depozituar në llogari të bashkëshortes Zhanina Proda, nr. *****, në bankën BKT.

Totali = 63 muaj x 20.000 lekë = 1, 260, 000 lekë. Shuma 1, 260, 000 lekë.

- ❖ Të ardhura nga kredi me kufi, overdraft, e datës 20.10.2005, ndryshuar në datën 16.08.2013. Shuma 150, 000 lekë. Aktualisht, shuma është gjendje në llogarinë nr. *****. Shuma 150, 000 lekë.
- ❖ Të ardhura të realizuara nga fitimi si ortak i thjeshtë me shoqërinë Sara & Kristi, nga 01.06.2017 deri në datë 06.02.2018, në masën 50%, shuma 150, 851 lekë. Shoqëria ka pushuar së funksionuari më datë 06.12.2018.
- ❖ Depozitë me afat në Tirana Bank, me numër llogarie *****, depozitim të kursimeve familjare krijuar në datë 24.12.2009, mbyllur në datë 24.06.2011, derdhje fillestare 3, 000 euro, fitimi nga interesat 127 euro. Shuma 3, 127 euro.
- ❖ Depozitë me afat në Raiffeisen Bank, me numër llogarie *****, kursime familjare krijuar në datë 27.01.2011, mbyllur në datë 27.12.2011, derdhje fillestare 6, 000 euro, fitimi nga interesat 37 euro. Shuma 6, 037 euro.
- ❖ Të ardhura nga shitja e automjeteve si vijon:
 - Automjet Renault Skenik, vit prodhimi 2001, shuma 1, 000 euro.
 - Automjet Mercedes Benz C200, vit prodhimi 2001, shuma 200, 000 lekë.
 - Automjet Peugeot 3008, vit prodhim 2010, shuma 3, 000 euro.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Nxjerrje llogarie bankare pranë Raiffeisen Bank, në emër të Ilir Proda, ku konfirmohen kreditimi i pagave, për periudhën 19.04.2018 - 14.02.2023.
- Formular i deklarimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për subjektin “Sara & Kristi” sh.p.k, me NIPT L7*****E, për vitin 2017, ku të ardhurat janë në vlerën 875, 011 lekë, shpenzimet janë në vlerën 573, 309 lekë, fitimi në vlerën 301, 702 lekë.
- Kontratë qiraje e pasurisë së paluajtshme, datë 01.10.2017, datë 01.10.2018, datë 01.10.2019, datë 01.10.2020, datë 01.10.2021 dhe datë 01.10.2022, me palë qiradhënëse Zhanina Proda dhe palë qiramarrëse P. C, të objektit apartament, me sip. 52, 9 m², në Tiranë, rinovuar çdo vit, në vlerën 20, 000 lekë neto në muaj. Qiradhënësi do të jetë përgjegjës për çdo taksë, mbi pasurinë që është e pagueshme nga pronari, apo ndonjë taksë tjetër, të ndryshueshme nga tatimi mbi të ardhurat.
- Nxjerrje llogarie bankare datë 31.12.2011, në Tirana Bank, në emër të Ilir Proda, ku në datën 24.06.2011 është maturuar depozita në vlerën 3, 000 euro, interes në vlerën 127 euro.

- Nxjerrje llogari bankare datë 19.04.2018, në Raiffeisen Bank, në emër të Ilir Proda, ku në datën 27.11.2011 është çelur depozita në vlerën 6, 000 euro dhe maturuar në datë 27.06.2012, interesi është në vlerën 37 euro.
- Kontratë shitblerje automjeti, nr. ***, datë 07.03.2015, me palë shitëse Ilir Proda dhe palë blerëse A. B, të mjetit tip Renault Megane, me targa AA *** CU, në vlerën 1, 000 euro.
- Kontratë shitblerje automjeti, nr. ***, datë 02.11.2017, me palë shitëse Ilir Proda dhe palë blerëse Gj. K, të mjetit tip Peugeot 3008, me targa AA *** PS, në vlerën 3, 000 euro.
- Kontratë shitje pasuri e luajtshme, nr. ***, datë 19.08.2021, me palë shitëse Ilir Proda dhe palë blerëse S. B, të mjetit tip Mercedes Benz, me targa AA *** KS, në vlerën 200, 000 lekë.

Procedura e vlerësimit:

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë kontrolli mbi të ardhurat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke analizuar të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion në funksion të hetimit administrativ, si dhe ka kryer verifikime në institucionet përgjegjëse, të cilat kanë dërguar përgjigjet përkatëse, konkretisht:

Raiffeisen Bank, me shkresën nr. ***, prot., datë 08.05.2023, përcjell nxjerrje llogari bankare të Ilir Proda, ku konfirmohet kreditimi i pagave, dieta, shpërblime etj. për periudhën 02.09.2005 - 09.03.2023, në vlerën rreth 15, 414, 000 lekë.

Gjithashtu, subjekti ka pasur depozitë në shumën 6, 000 euro, krijuar në datë 27.01.2011, mbyllur në datë 27.12.2011, derdhje fillestare 6, 000 euro, fitimi nga interesat 37 euro.

Banka Kombëtare Tregtare, me shkresën nr. ***, prot., datë 09.05.2023, përcjell nxjerrje llogari bankare të Zhanina Proda, ku pagesat e qirasë kryhen nga shtetasja P. C, për periudhën mars 2018 - 08.03.2023, në shumat mujore prej 20, 000 lekë.

Tirana Bank, me shkresën nr. ***, prot., datë 12.05.2023, përcjell nxjerrje llogari bankare të Ilir Proda, ku konfirmon se ka patur depozitë bankare në vlerën 3, 000 euro krijuar në datë 24.12.2009, mbyllur në datë 24.06.2011, fitimi nga interesat 127 euro. Gjendja në datën 09.03.2023 është 0 euro.

Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, me shkresën nr. ***, prot., datë 15.05.2023, në lidhje me kontratat e qirasë për vitin 2017- 2022, konfirmon se nuk janë kryer pagesa për tatimin në burim nga ana e shtetas Zhanina Proda dhe P. C.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore, me shkresën nr. ***, prot., datë 10.05.2023, konfirmon të ardhura të realizuara nga shtetasi Ilir Proda gjatë periudhës janar 2012 - mars 2023, pranë subjekteve Drejtoria e Policisë Qarku Lezhë, Komisariati i Policisë Dibër, Drejtoria për Hetimin e Krimit të Organizuar dhe Krimet e Rënda, Drejtoria e Policisë Qarku Korçë, Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan.

Në procesverbalin e datës 05.10.2023, në lidhje me pagesën e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat nga qiradhënia, subjekti sqaroi se, pavarësisht citimit në kontratë, ka paguar tatimin në burim dhe paraqiti njoftim debitimi në Raiffeisen Bank dhe DIVA në emër të Ilir Proda, si vijon:

- ✓ Njoftim debitimi datë 30.05.2023, në Raiffeisen Bank, nga Ilir Proda, të shumës 189, 000 lekë me përshkrimin “Tatimi i të ardhurave me përfitues Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”. Urdhër pagesë të tatimit mbi të ardhurat individuale, datë 30.05.2023 dhe datë 01.06.2023, në shumën 189, 000 lekë + gjobë në vlerën 7, 508 lekë.
- ✓ Deklaratë individuale vjetore e të ardhurave për periudhën 2017 - 2022, në emër të Ilir Proda.

Konkluzion:

- *Të ardhurat e subjektit nga paga, shpërblime, veshje, dieta etj., për periudhën shtator 2005 – mars 2023, janë në shumën totale rreth 15, 414, 000 lekë.*
- *Të ardhurat nga qiradhënia e apartamentit në rr. “****”, Tiranë, për periudhën 2017 - mars 2023, janë në shumën 1, 260, 000 lekë. Subjekti ka paguar detyrimet tatimore në shumën rreth 190, 000 lekë.*
- *Të ardhura nga interesat bankare në vlerën 164 euro.*
- *Referuar analizës financiare (Aneksi 1), subjekti i vlerësimit ka patur të ardhura të ligjshme dhe të mjaftueshme me qëllim kursimin e vlerës prej 3, 000 euro në vitin 2009 dhe vlerës 6, 000 euro në vitin 2011.*
- *Aktiviteti i subjektit është trajtuar më lart.*

Deklarimi i detyrimeve financiare të subjektit të vlerësimit

Në mbështetje të nenit 33, pika 1/c, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, subjekti i cili i nënshtrohet vlerësimit, deklaron detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë (kredi, huamarrje, detyrim ndaj të tretëve, etj.), që ekzistojnë brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të mbetura ende pa u shlyer deri në datën e dorëzimit të formularit të deklaratës së pasurisë.

Subjekti i vlerësimit ka deklaruar detyrimet financiare si më poshtë:

- 1.** Kredi bankare nga banka BKT, shuma 3, 390, 000 lekë, fillimi i detyrimit më datë 27.08.2012, mbarimi i detyrimit më datë 29.08.2042. Interesi bazë i kredisë 3%, kësti mujor aktual 16, 050 lekë. Shuma e mbetur pa shlyer 2, 546, 445 lekë. Këstet e kredisë paguhen në llogarinë nr. *****, në emër të subjektit. Shuma e mbetur e pa shlyer 2, 546, 445 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetim nr. ***, prot., datë 20.02.2023 nga BKT, që konfirmon se Ilir Proda ka marrë kredi bankare në vlerën 3, 390, 000 lekë, në datë 27.08.2012. Në datë 31.12.2022, detyrimi i mbetur i kredisë bankare është në vlerën 2, 546, 445 lekë. Aneks i planit të pagesës për vitin 2022, nga banka BKT, në emër të Ilir Proda.
- Nxjerrje llogarie bankare në BKT, në emër të Ilir Proda, ku kryhen pagesat e kësteve të kredisë bankare për periudhën 14.01.2022 - 15.12.2022.

Procedura e vlerësimit:

Banka Kombëtare Tregtare, me shkresën nr. ***, prot., datë 09.05.2023, konfirmon se shtetasi Ilir Proda ka kredi bankare me detyrim financiar të mbetur në vlerën 2, 546, 445 lekë.

Bashkëlidhur, nxjerrje llogari bankare.

Konkluzion:

Duke analizuar të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion në funksion të hetimit administrativ, rezulton se:

- ***Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e BKT.***
- ***Detyrimi i mbetur pa shlyer deri më datë 09.03.2023, nga ana e subjektit të vlerësimit është në vlerën 2, 546, 445 lekë.***

2. Huamarrje pa interes nga person fizik, shuma 52, 000 euro, fillimi i detyrimit datë 01.02.2017, mbarimi i detyrimit pa afat deri në shlyerjen e shumës. Vërtetuar me deklaratë nr. *** rep, nr. *** kol., datë 11.02.2017.

- Shlyer nga data 01.02.2017, deri në datë 21.04.2018, shuma 5, 000 euro. Vërtetuar me deklaratë noteriale nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 21.04.2018.
- Shlyer nga data 21.04.2018, deri në datë 31.12.2019, shuma 3, 000 euro. Vërtetuar me deklaratë noteriale nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 31.12.2019.
- Shlyer nga data 31.12.2019, deri në datë 13.08.2021, shuma 7, 000 euro. Vërtetuar me deklaratë noteriale nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 13.08.2021.
- Shlyer nga data 13.08.2021, deri në datë 10.11.2022, shuma 7, 000 euro. Vërtetuar me deklaratë noteriale nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 10.11.2022. Shuma e mbetur pa shlyer 30, 000 euro.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Deklaratë noteriale nr. *** kol, datë 11.02.2017, ku shtetasi Y. C, pronar i kompanisë “Star ***” sh.p.k, deklaroi se në dhjetor të vitit 2014, ka lidhur një marrëveshje verbale me ndërtuesin O. C, administrator i firmës së ndërtimit “*** sh.p.k”, për porositjen e një apartamenti, në vlerën 52, 000 euro (70 milion lekë të vjetra), adresa rr. “***”, Tiranë, afër shkollës “***”. Shumën do ta paguante me këste sipas ecurisë së punimeve. Këtë marrëveshje i’a ka bërë me dije mikut të tij, Ilir Proda, i cili i ka kërkuar që këtë apartament ta blinte ai, por meqenëse Ilir Proda nuk ka pasur mundësi financiare, i ka kërkuar deklaruesit të bënte pagesën e kësteve dhe shumën në fjalë të njëjtit si borxh. Deklaruesi ka dashur t’a ndihmojë Ilir Proden, pasi ka miqësi me të dhe babain e tij, Agim Proda. Për këtë arsye, i ka paguar këstet e apartamentit, ndërtuesit, O. C, pavarësisht se kontrata e porosisë është lidhur midis ndërtuesit dhe Ilir Proda. Në momentin kur apartamenti është bërë gati për dorëzim, me anën e një shkresë nga ana e kompanisë, Y. C, i ka njohur si borxh Ilir Prodes shumën 52, 000 euro (70 milion lekë), të paguar prej tij për apartamentin në fjalë. Me shtetasin Ilir Proda ka rënë dakord që borxhi në vlerën 52, 000 euro të shlyhet me këste çdo muaj, 500 euro, sipas mundësisë financiare deri sa shuma të shlyhet plotësisht. Pasi është dorëzuar apartamenti, është lidhur kontrata midis ndërtuesit dhe Ilir Proda.

- Deklaratë noteriale nr. ***, datë 21.04.2018, me deklaruesit Y. C dhe Ilir Proda, ku palët deklarojnë se Ilir Proda ka paguar shumën 5, 000 euro, shtetasit Y. C, dhe ky i fundit deklaroi se ka marrë vlerën 5, 000 euro. Palët deklarojnë se detyrimi i mbetur është në shumën 47, 000 euro, shumë e cila do të shlyhet ndër vite.
- Deklaratë noteriale nr. ***, datë 31.12.2019, me deklaruesit Y. C dhe Ilir Proda, ku palët deklarojnë se: Në datë 21.04.2018, kanë lidhur kontratën e qirasë nr. ***. Gjithashtu, në deklaratën nr. ***, datë 11.02.2017, Y. C i ka dhënë në formë huaje, shumën prej 52, 000 euro, shtetasit Ilir Proda, ku vlera 5, 000 euro është shlyer më datë 21.04.2018 dhe detyrimi i mbetur është 47, 000 euro. Sot, me nënshkrimin e deklaratës, Ilir Proda ka shlyer shumën prej 3, 000 euro dhe shuma e detyrimit është 44, 000 euro. Shtetasi Y. C, deklaroi se ka marrë shumën prej 3, 000 euro, nga shuma totale që i detyrohet.
- Deklaratë noteriale nr. ***, datë 13.08.2021, me deklaruesit Y. C dhe Ilir Proda, me objekt “Për likuidim të pjesshëm dhe njohje të detyrimit financiar”. Ilir Proda, deklaroi se në datë 11.02.2017, ka hyrë në një marrëdhënie huaje, nëpërmjet deklaratës noteriale nr. ***, datë 11.02.2017, duke i njohur shtetasit Y. C detyrimin në vlerën 52, 000 euro (ose 7, 000, 000 lekë), ku është përcaktuar dhe mënyra e likuidimit të detyrimit financiar. Shuma 5, 000 euro është shlyer më datë 21.04.2018, dhe shuma 3, 000 euro më datë 31.12.2019, nëpërmjet deklaratës noteriale nr. ***, datë 31.12.2019, detyrimi i mbetur është 44, 000 euro. Deklaruesi Y. C, deklaroi se sot, ka marrë shumën financiare prej 7, 000 euro, si likuidim i pjesshëm i detyrimit, detyrimi i mbetur është në shumën 37, 000 euro. Ilir Proda deklaroi se detyrimi i mbetur është në vlerën 37, 000 euro.
- Deklaratë noteriale nr. ***, datë 10.11.2022, me deklaruesit Y. C dhe Ilir Proda, me objekt “Për likuidim të pjesshëm dhe njohje të detyrimit financiar”. Ilir Proda, deklaroi se në datë 11.02.2017, ka hyrë në një marrëdhënie huaje, nëpërmjet deklaratës noteriale nr. ***, datë 11.02.2017, duke i njohur shtetasit Y. C detyrimin në vlerën 52, 000 euro (ose 7, 000, 000 lekë) ku është përcaktuar dhe mënyra e likuidimit të detyrimit financiar. Në datë 21.04.2018, i ka shlyer shtetasit Y. C, shumën 5, 000 euro dhe më datë 31.12.2019, shumën 3, 000 euro, e vërtetuar nëpërmjet deklaratës noteriale nr. ***, datë 31.12.2019. Nëpërmjet deklaratës noteriale nr. ***, datë 13.8.2021, ka likuiduar shumën 7, 000 euro. Deklaruesi Y. C, deklaroi se, më datë 10.11.2022, është likuiduar shuma prej 7, 000 euro, nga Ilir Proda, si likuidim i pjesshëm i detyrimit. Detyrimi i mbetur është në shumën 30, 000 euro. Ilir Proda deklaroi se detyrimi i mbetur është në vlerën 30, 000 euro.

Në procesverbalin e datës 05.10.2023, subjekti deklaroi se detyrimet ndaj shtetasit Y. C janë paguar cash, me burim kursimet familjare, në shumën totale prej 22, 000 euro, referuar dhe deklaratave noteriale që ka dorëzuar.

Me qëllim vlerësimin e ligjshmërisë së të ardhurave financiare si dhe vlerësimin e mundësisë për kursimin e vlerës prej 22, 000 euro nga periudha 01.02.2017 - 10.11.2022, Trupa e Vlerësimit kreu analizën financiare përkatëse e cila ndodhet bashkëlidhur këtij relacioni (Aneksi 1).

Konkluzion:

Bazuar në deklarimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën administruar nga Trupa e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur rezulton se;

- *Shuma e marrë hua në vlerën 52, 000 euro ndaj shtetasit Y. C, përdorur për blerjen e apartamentit në rr. “***”, Tiranë, gjatë periudhës 2017 – 2022, është likuiduar në vlerën totale 22, 000 euro.*
- *Detyrimi i mbetur pa shlyer është në shumën 30, 000 euro.*
- *Shlyerja dhe detyrimi janë dokumentuar me deklarata noteriale ndërmjet palëve.*
- *Subjekti ka dhënë sqarime në lidhje me pagesën e detyrimeve për huanë, në shumën 22, 000 euro, ndaj shtetasit Y. C, të konfirmuara me deklaratat noteriale ndër vite.*
- *Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar pranë Trupës së Vlerësimit,*
- *Subjekti i vlerësimit referuar analizës financiare, ka patur të ardhura të mjaftueshme me qëllim pagesën e detyrimit në vlerën 22, 000 euro për periudhën 2017 – 2022.*

Deklarimi i shpenzimeve të subjektit të vlerësimit.

Në mbështetje të nenit 33, pika 1/ç, d, dh, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, subjekti i cili i nënshtrohet vlerësimit, deklaron shpenzimet e vitit të fundit për qira banese, ujë, drita, telefon dhe internet, si dhe të gjitha pagesat periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të tij ose të personave të lidhur; udhëtimet private personale apo të personave të lidhur jashtë territorit shqiptar gjatë 3 (tre) viteve të fundit, duke specifikuar shtetin, vendin e qëndrimit, kohëzgjatjen, shpenzimet e përballuara; arsimin e fëmijëve, madhorë apo të mitur, në momentin e deklaramit apo të personave të lidhur, duke deklaruar fillimin, llojin e institucionit arsimor, emrin e institucionit, pagesat vjetore, si dhe kohëzgjatjen e studimeve.

✚ Në mbështetje të nenit 33, pika 1/ç, subjekti deklaron:

1. Shpenzime për ujë të pijshëm, janar 2022 deri janar 2023, paguar shuma totale 34, 298 lekë.
2. Shpenzime për energji elektrike, periudha mars 2022 deri shkurt 2023, paguar shuma totale 110, 651 lekë.
3. Shpenzime për telefon, numra telefonikë të subjektit dhe familjarëve, përafërsisht rreth 39, 000 lekë, total x 12 muaj = 46, 800 lekë.
4. Shpenzime për internet, 2, 000 lekë në muaj x 12 muaj = 24, 000 lekë. Shpenzime për Digitalb, oferta vjetore 9, 900 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratat e qirave të datave 01.10.2017, 01.10.2018, 01.10.2019, 01.10.2020, 01.10.2021, 01.10.2022, me palë qiradhënëse Zhanina Proda dhe palë qiramarrëse P. C, të apartamentit me sip. 52, 9 m², në adresën rr. “***” në Tiranë, ku përcaktohet se qiramarrësi ka detyrimin të paguajë në kohë shpenzimet për ujë dhe drita.

Procedura e vlerësimit:

Furnizuesi i Shërbimit Universal, me shkresën ***, prot., datë 19.05.2023, konfirmon se Ilir Proda është abonent me kontratën e furnizimit të energjisë elektrike, me nr. TR2***** dhe nr. TR3*****, në Tiranë. Ka bashkëlidhur informacionin si më poshtë:

- Klienti Ilir Proda, me kontratë me nr. TR3*****, adresa rr. "****", Tiranë, bashkëlidhur pagesat për periudhën 17.01.2022 - 15.12.2022, në vlerën rreth 110, 603 lekë.
- Klienti Ilir Proda, me kontratë me nr. TR2*****, adresa rr. "****", Tiranë bashkëlidhur pagesat për periudhën 31.01.2022 - 20.12.2022, në vlerën rreth 46, 756 lekë.

Shoqëria Rajonale Ujësjetllës - Kanalizime Tiranë, me shkresën nr. ***, prot., datë 12. 06.2023, konfirmon se në emër të Ilir Agim Proda, rezulton kontratë nr. ***-1, për objektin me adresë rr. "****", Tiranë, me status aktiv, në kategorinë e konsumatorëve familjarë, me detyrim të pa likuiduar, me vlerë 1, 589 lekë deri në datën 18.05.2023. Nga kontrolli në arkivin e UKT sh. a., nuk disponohet asnjë dokument që vërteton që Ilir Proda ka të njëjtat gjeneralitete me personin e kërkuar në shkresë. Bashkëlidhur, fletë nga sistemi i menaxhimit të informacionit për kontratën nr. ***-1, ku shpenzimet për periudhën janar 2022 - dhjetor 2022, janë në vlerën 19, 910 lekë.

14 Shoqëritë Rajonale të Ujësjetllës - Kanalizime, nuk konfirmojnë kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

Vodafone Albania sh.a., në shkresat nr. ***, prot., datë 12.06.2023, datë 16.06.2023, ka bashkëlidhur informacion në lidhje me Komisarriatin e Policisë nr. 3, Tiranë, ku në emër të Ilir Proda rezulton i regjistruar numri i celularit 06941***** (inaktiv), nga data 13.12.2007 deri në datë 09.05.2022. Pagesa për numrin 06941***** është në shumën 3, 358 lekë, për periudhën janar 2022 - prill 2022. Bashkëlidhur praktika përkatëse.

Gjithashtu, ky shtetas ka pasur të regjistruar numrat: 0698*****, nga data 27.03.2014 deri në datë 18.11.2015; 0692*****, nga data 29.03.2007 deri në datë 06.08.2019.

One Albania sh.a., me shkresën nr. ***, prot., datë 22.06.2023, konfirmon se në emër të Ilir Proda, figuron i regjistruar numri 06941*****, dhe shpenzimi për periudhën janar 2022 - dhjetor 2022 është në vlerën 25, 953 lekë. Nëpërmjet CD, përcillet informacion në lidhje me Ilir Proda, forma e kërkesës për mbartjen e numrit 06941***** nga operatori Vodafone drejt operatorit One. Bashkëlidhur praktika e abonimit.

Albania Satellite Communications sh.p.k., me shkresën nr. ***, prot., datë 15.05.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

Abissnet sh.a. me shkresën nr. ***, prot., datë 11.05.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

Digicom sh.a., me shkresën nr. ***, prot., datë 12.05.2023, konfirmon se Zhanina Proda ka marrë shërbime interneti me kontratë nr. DG-18-***-R, me vlerë faturimi mujor në shumën 1, 990 lekë, për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022.

Në procesverbalin e datës 03.10.2023, subjekti ka paraqitur dokumentacion në lidhje me kontratën e ujit dhe energjisë elektrike të apartamentit në rr. "****", Tiranë. Për shpenzimin e dritave ka deklaruar periudhën mars 2022 deri shkurt 2023.

Në lidhje me shpenzimet e ujit dhe energjisë elektrike të apartamentit me sip. 52, 9 m², me adresë rr. "****", sqaroi se paguhen nga pala qiramarrëse nga viti 2017 e në vazhdim. Në kontratat e paraqitura bashkëlidhur deklaratës, ndër të tjera citohet se, qiramarrësi do të pagujë në kohë

faturat për energji elektrike dhe ujin. Në lidhje me konstatimin e Vodafone edhe One Albania, saktësoi se numri është i regjistruar në emër të institucionit, por pagesat kryhen nga subjekti.

Në lidhje me pagesat për Digitalb, sqaroi se pagesa është në shumën 9, 900 lekë, e cila është ofertë vjetore.

Në lidhje me deklarinimin e shumës 39, 000 lekë në muaj për shpenzime telefonike, saktësoi vlerën prej 3, 900 lekë në muaj. Paraqiti:

- Shkresë e OSHEE për historikun e faturave në emër të Ilir Proda, me kontratë me nr. TR1*****, listë e pagesave për periudhën tetor 2022 - shtator 2023.
- Listën e faturave të paguara për kontratën nr. TR1*****, për periudhën janar 2022 - dhjetor 2022, në shumën 110, 601 lekë.
- Shkresë e OSHEE për informacion mbi kontratën e furnizimit të energjisë elektrike me nr. TR2*****, në adresën rr. "****", në emër të Ilir Proda.
- Moduli i Konsultimit të Informacionit Online, nga UKT Tiranë, për abonentin Ilir Proda, me nr. kontrate ***, në adresën rr. "****", Tiranë, ku shpenzimet për periudhën janar 2022 - dhjetor 2022, janë në shumën 31, 100 lekë.
- Moduli i Konsultimit të Informacionit Online, nga UKT Tiranë, për abonentin Ilir Proda, me nr. kontrate 00723 7-1.

Konkluzion:

- ***Informacionet e dërguara nga institucionet përgjegjëse, përputhen me deklarinimin e subjektit të vlerësimit.***
- ***Subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumentacion justifikues në lidhje me pagesat e ujit dhe të energjisë elektrike për apartamentin në adresën rr. "****", Tiranë, të cilat paguhen nga pala qiramarrëse.***
- ***Shpenzimet e deklaruara për ujë, drita, telefon dhe internet, gjatë periudhës së sipërcituar, janë në shumën rreth 174, 000 lekë.***

✚ Në mbështetje të nenit 33, pika 1/d, subjekti deklaron:

- Muaji dhjetor 2022, udhëtim tre netë në Shkup, Maqedoni, ka kryer shpenzime rreth 100 euro, pasi ka qenë me trajnim dhe shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe ushqimit, janë paguar nga organizatorët.
- Muaji korrik 2022, udhëtim një natë në Selanik, Greqi, nuk ka kryer shpenzime, pasi ka qenë me shërbim për arsye pune.
- Muaji mars 2022, udhëtim dy netë në Mal të Zi, për pushime me familjen, shpenzime rreth 300 euro.
- Muaji korrik 2021, një ditë në Kozani, Greqi, nuk ka kryer shpenzime, pasi ka qenë me shërbim për arsye pune.
- Muaji korrik 2021, udhëtim katër netë në Mal të Zi, pushime verore, shpenzime rreth 600 euro.
- Muaji nëntor 2019, udhëtim dy netë në Strugë, Maqedoni, shpenzime rreth 200 euro.
- Muaji shtator 2019, udhëtim tre netë në Sivota, Greqi, shpenzime rreth 400 euro.

- Muaji maj 2019, udhëtim njëmbëdhjetë netë në Hagë, Holandë, nuk ka kryer shpenzime, për shkak se ka qenë në trajnim, dhe udhëtimi, akomodimi, fjetja dhe një sasi prej 600 euro për shpenzime janë dhënë nga organizatorët.
- Muaji dhjetor 2018, udhëtim dy netë në Stamboll, Turqi, ndërsa familja ka qëndruar 5 netë, pasi ka bërë disa vizita mjekësore për vajzën e tij, shpenzime gjithsej rreth 1, 000 dollarë.
- Muaji gusht 2018, udhëtim pesë netë për pushime në Igumenicë, Greqi, shpenzime rreth 600 euro.
- Muaji prill 2018, udhëtim dy netë në Salzburg, Austri, shpenzime rreth 100 euro, pasi ka qenë pjesëmarrës në workshop. Udhëtimi, akomodimi dhe ushqimi, kanë qenë të paguara nga organizatorët.
- Muaji nëntor 2022, udhëtim tre netë në Romë, Itali, ka udhëtuar bashkëshortja Zhanina Proda, për shoqërim të motrës së saj, shpenzime gjithsej 300 euro.
- Bashkëshortja Zhanina Proda ka disa udhëtime për periudhën e deklaruashme vajtje - ardhje në Kosovë, për arsye pune, për llogari të Entit të Banesave, nuk ka kryer shpenzime.

Procedura e vlerësimit:

Në procesverbalin e datës 05.10.2023, subjekti u pyet në lidhje me deklarinimin e udhëtimeve dhe dokumentacionin shoqëruar në lidhje me hyrje - daljet, të konfirmuara nga sistemi TIMS. Subjekti sqaroi se ka udhëtuar për arsye pune në datë 12.12.2022, tre netë në Shkup, Maqedoni, paraqiti urdhrin nr. 1381, datë 22.11.2022, ku ka shpenzuar rreth 100 euro, për shpenzime gjatë ditëve.

Udhëtim për punë në datë 21 korrik 2022, një natë në Selanik, Greqi, ka qenë një takim operacional më pak se 24 orë, nuk ka pasur shpenzime pasi janë pritur nga pala greke.

Në datën 12.05.2022, ka udhëtuar për qëllime pune takim operacional më pak se 24 orë, në Qafë Thanë pa shpenzime, por sistemi nuk ka të regjistruar ditën e daljes.

Më datë 11 mars 2022, dy netë në Mal të Zi, për pushime me familjen me shpenzime rreth 300 euro.

Më datë 8 korrik 2021, një ditë në Kozani, Greqi, një takim operacional më pak se 24 orë, nuk ka pasur shpenzime, urdhër shërbimi nuk ka në këto raste.

Ka të regjistruar hyrje në datë 16 korrik 2021, katër netë në Mal të Zi, pushime verore, shpenzime rreth 600 euro. Saktësoi se sistemi nuk ka të regjistruar datën e daljes.

Bashkëshortja ka udhëtuar nga data 16.11.2022 - 19.11.2022, tre netë në Romë, Itali, për shoqërim të motrës së saj, shpenzime gjithsej 300 euro.

Bashkëshortja Zhanina Proda, ka disa udhëtime për periudhën e deklaruashme vajtje - ardhje në Kosovë, për arsye pune, për llogari të Entit të Banesave, nuk ka kryer shpenzime. Saktësoi se, hyrja në datë 24.06.2020 dhe dalja në datë 24.06.2020, janë për llogari të Entit të Banesave, ku në sistem, dalja është regjistruar dy herë. Gjithashtu, hyrja dhe dalja në datat 27.07.2021 dhe 15.12.2021 rezulton me dy regjistrime në dalje nga sistemi dhe një në hyrje.

Banka Credins ka ofruar një udhëtim në datat 20.05.2022 - 22.05.2022, për personelin e Entit të Banesave në Selanik, për të cilin paraqiti dokument. Të gjitha këto udhëtime, kanë qenë pa shpenzime. Bashkëshortja nuk ka urdhër për lëvizjet nga Enti i Banesave.

Subjekti paraqiti kopje të TIMS, në emrin e tij dhe të familjareve. Sqaroi se, nëse ka ndonjë pasaktësi në lidhje me datat e hyrjes dhe të daljes, kjo ndodh për shkak të problemeve të sistemit dhe regjistrimit të tij.

Subjekti ka deklaruar dhe shpenzime për udhëtime personale për vitin 2018 - 2019 për transparencë, ku saktësoi se në vitin 2018, ka udhëtuar me familjen në Turqi dhe ka kryer disa analiza shëndetësore për vajzën, referuar deklaramit më lart, në vlerën totale 1, 000 dollarë.

Paraqiti: *Kopje e sistemit TIMS, të hyrje - daljeve, për Ilir Proda, për periudhën 2006 - 12.12.2022, ku rezulton:*

- Dalje datë 12.12.2022, hyrje në datë 15.12.2022, me auto veturë.
- Dalje datë 21.07.2022, hyrje në datë 22.07.2022, me auto veturë.
- Hyrje në datë 12.05.2022, me auto veturë.
- Dalje datë 11.03.2022, hyrje në datë 13.03.2022, me auto veturë.
- Dalje datë 08.07.2021, hyrje në datë 08.07.2021, me auto veturë.
- Hyrje në datë 12.05.2022, me auto veturë.
- Urdhër për dërgimin me shërbim jashtë shtetit nr. 1381, datë 22.11.2022, nga Ministria e Brendshme në emër të Ilir Proda, për të marrë pjesë në një aktivitet rajonal të zhvilluar në datat 13 - 14 dhjetor, në Shkup, Maqedoninë e Veriut, data e nisjes 12.12.2022 dhe data e kthimit 15.12.2022, nëpërmjet linjës tokësore.
- Dalje datë 17.12.2018, hyrje në datë 19.12.2018, në Stamboll.

Kopje e sistemit TIMS, të hyrje - daljeve për shtetasen Zhanina Proda, për periudhën 2009 - 15.09.2023, ku rezulton

- Dalje datë 16.11.2022, hyrje në datë 19.11.2022, në Rinas.
- Dalje datë 20.05.2022, hyrje në datë 22.05.2022, me autobus.
- Dalje datë 11.03.2022, hyrje në datë 13.03.2022, me auto veturë.
- Dalje datë 15.12.2021, hyrje në datë 15.12.2021, me auto veturë.
- Dalje datë 15.12.2021, hyrje në datë 15.12.2021, me auto veturë.
- Dalje datë 27.07.2021 me auto veturë, hyrje në datë 16.07.2021, me auto veturë.
- Dalje datë 24.06.2020, hyrje në datë 24.06.2020, me auto veturë.
- Dalje datë 24.06.2020, me auto veturë. Faturat elektronike për udhëtim turistik jashtë shtetit, për klientin Enti Kombëtar i Banesave, datë 16.05.2022.
- Dalje datë 17.12.2018, hyrje në datë 21.12.2018, në Stamboll.

Kopje e sistemit TIMS, të hyrje - daljeve për shtetasen Kristi Proda dhe Isel Proda, për periudhën 2011 - 15.09.2023.

- Dalje datë 11.03.2022, hyrje në datë 13.03.2022, me auto veturë.
- Hyrje në datë 16.07.2021, me auto veturë.

Konkluzion:

- *Deklarimi përputhet me dokumentacionin e dorëzuar sa i përket hyrje – daljeve nga Republika e Shqipërisë, gjatë periudhës 2020 – 2023, të subjektit dhe personave të lidhur me të.*
- *Subjekti dha shpjegime dhe paraqiti dokumentacionin për sa i përket hyrje - daljeve të tij dhe personave të lidhur me të nga Republika e Shqipërisë gjatë periudhës 2020 - 2023.*
- *Subjekti ka deklaruar shpenzimet për udhëtim për periudhën objekt vlerësimi.*
- *Shpenzimet e deklaruara për udhëtimet private, personale dhe të personave të lidhur për periudhën janar 2020 - dhjetor 2022, rezultojnë në total rreth 1, 300 euro, e konvertuar në shumën 149, 000 lekë.*

✚ Në mbështetje të nenit 33, pika 1/dh, subjekti deklaron:

1. Shpenzime për pagesë kopshti “****”, “****”, adresa rr. “****” për vajzën Isel Proda. Viti 2021, shuma 106, 000 lekë. Viti 2021, shuma 110, 000 lekë.

Procedura e vlerësimit:

Në procesverbalin e datës **05.10.2023**, subjekti paraqiti dokumentacion në lidhje me deklarinimin e shpenzimeve të kopshtit të vajzës, e paguar me dy këste. Vajza ka qenë në kopsht vetëm një vit. Konfirmon se shuma totale e paguar është 110, 000 lekë, referuar dokumentacionit.

Subjekti sqaroi se, vajza Kristi Proda ka studiuar dhe studion në shkollën 9- vjeçare publike “****” dhe ka përfituar bursë si nxënëse e shkëlqyer për të cilën paraqiti dokumentacion. Bashkëshortja nuk ka kryer shpenzime për arsimim.

Credins Bank, me shkresën nr. ***, prot., datë 30.05.2023, konfirmon se Kristi Proda ka pasur llogari bankare pranë kësaj banke. Bashkëlidhur, nxjerrje llogarie, ku është kredituar bursa, si nxënëse me rezultate të larta.

Subjekti i vlerësimit ka kryer studime, për të cilat paraqiti vërtetim nga Fakulteti i Drejtësisë për programin “Bachelor”, part - time dhe Master Shkencor Penal, si dhe vërtetim nr. ***, prot., datë 21.02.2023, nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë.

Subjekti paraqiti:

- Mandat elektronik, nga BKT, datë 09.12.2021, nga Zhanina Proda, në shumën 60, 000 lekë, me përshkrimin “pagesa kësti i parë i kopshtit, Isea Proda”.
- Mandat elektronik, nga BKT, datë 27.06.2022, nga Zhanina Proda, në shumën 50, 000 lekë, me përshkrimin “pagesa kësti i dytë i kopshtit, Isea Proda”.
- Deftesë në emër të Kristi Proda, për vitin shkollor 2022 - 2023 në shkollën publike “****”, Tiranë.
- Vërtetim nr. *** prot., datë 23.06.2023, nga Fakulteti i Drejtësisë, që konfirmon se tarifat e shkollimit për programin “Bachelor” (part - time) dhe Master Shkencor Penal për shtetasin Ilir Proda, janë si vijon:

- ✓ *Viti akademik 2009 - 2010, në shumën 93, 600 lekë.*
- ✓ *Viti akademik 2010 - 2011, në shumën 93, 600 lekë.*

✓ Viti akademik 2011 - 2012, në shumën 93, 600 lekë.

✓ Viti akademik 2012 - 2013, në shumën 62, 400 lekë.

- Vërtetim nr. ***, prot., datë 21.02.2023, nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë, konfirmon se Ilir Proda ka likuiduar tarifat zyrtare për fitimin e titullit "Avokat", për periudhën 23.09.2014 - 22.02.2016, në vlerën totale 238, 000 lekë.

Konkluzion:

- *Shpenzimet e deklaruara për arsimimin e subjektit dhe kopshtin e vajzës, deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë, rezultojnë në total 691, 000 lekë.*
- *Nga analiza financiare (Aneksi 1), rezulton se subjekti i vlerësimit ka patur të ardhura të ligjshme për të justifikuar shpenzimet e kryera për arsimim.*

DEKLARIMI I BASHKËSHORTES- ZHANINA PRODA

Deklarimi i pasurisë

Bashkëshortja e subjektit të vlerësimit, Znj. Zhanina Proda, në pasqyrën e deklarimit të pasurive dhe burimit të krijimit, ka deklaruar pasuritë si më poshtë:

- 1.** Depozitë me interes, banka Raiffeisen, derdhja e kursimeve familjare, nr. llogarie ***, krijuar më datë 24.02.2016, derdhja fillestare 1, 300, 000 lekë, depozituar gjatë periudhës 700, 000 lekë, tërhequr shuma në datën 31.01.2017, gjithsej 2, 000, 000 lekë. Burimi: Kursime familjare. Vlera 2, 000, 000 lekë. Zotërimi 50%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Nxjerrje llogari bankare, datë 12.04.2018, në Raiffeisen Bank, në emër të Zhanina Proda, ku në datën 24.02.2016, është depozituar shuma 1, 300, 000 lekë. Gjatë periudhës 19.04.2016 - 09.01.2017, janë depozituar vlera të ndryshme, të cilat përbejnë shumën 700, 000 lekë. Në datën 31.01.2017, tërhequr vlera 2, 000, 000 lekë, gjendja në datën 12.04.2018 është 0 lekë.

Procedura e vlerësimit:

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë kontrolli për depozitën bankare të deklaruar nga bashkëshortja e subjektit të vlerësimit, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke analizuar të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion në funksion të hetimit administrativ, si dhe ka kryer verifikime në institucionet përgjegjëse, të cilat kanë dërguar përgjigjet përkatëse në lidhje me deklaratimet apo mos deklaratimet e subjektit të vlerësimit, e konkretisht:

Raiffeisen Bank, me shkresën nr. ***, prot., datë 08.05.2023, përcjell nxjerrje llogari bankare të Zhanina Proda, ku rezulton se në datë 24.02.2016 është depozituar vlera 1, 300, 000 lekë. Gjatë periudhës 19.04.2016 - 09.01.2017, janë depozituar vlera të ndryshme të cilat përbejnë shumën

700, 000 lekë. Në datën 31.01.2017, tërhequr vlera 2, 000, 000 lekë, gjendja në datën 12.04.2018 është 0 lekë.

Ne procesverbalin e datës 05.10.2023, subjekti sqaroi se, për transparencë ka deklaruar lëvizjet në Raiffeisen Bank, me burim kursime ndër vite. Destinacioni i pakësimit të kësaj llogarie, kanë shkuar për shpenzime të ndryshme familjare dhe pagesën e kësteve të kredisë, të huasë, si dhe për mobilim.

Trupa e Vlerësimit me qëllim vlerësimin e ligjshmërisë së të ardhurave financiare si dhe vlerësimin e mundësisë për kursimin e shumës prej 2, 000, 000 lekë në periudhën 2016 - 2017, kreu analizën financiare përkatëse e cila ndodhet bashkëlidhur këtij relacioni (Aneksi 1).

Konkluzion:

Bazuar në deklarinë e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga Trupa e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur rezultojnë se:

- *Deklarimi i personit të lidhur me subjektin e vlerësimit, përputhet me përgjigjen e institucionit bankar.*
- *Subjekti i vlerësimit dhe bashkëshortja e tij, referuar analizës financiare, kanë patur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme, me qëllim kursimin e shumës prej 2, 000, 000 lekë gjatë periudhës 2016 – 2017.*

2. Gjendje në llogarinë rrjedhëse me nr. ***, banka Credins, shuma 5, 929 lekë. Vlera 5, 929 lekë. Zotërimi 100%.

Bashkëlidhur deklaratës:

Nxjerrje llogari bankare, datë 16.02.2023, në Credins Bank në emër të Zhanina Proda, ku i kreditohen pagat për periudhën 01.01.2018 - 16.02.2023.

Procedura e vlerësimit:

Credins Bank, me shkresën nr. ***, prot., datë 30.05.2023, konfirmon se Zhanina Proda ka llogari page me gjendje në vlerën 5, 929 lekë.

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë verifikimi të llogarisë së personit të lidhur me subjektin e vlerësimit, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ku rezultojnë se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë llogari bankare. Deklarimi përputhet me dokumentacionin e administruar.

3. Gjendje në llogarinë rrjedhëse nr. *****, banka BKT, shuma 24, 095 lekë. Vlera 24, 095 lekë. Zotërimi 100%.

Bashkëlidhur deklaratës:

Nxjerrje llogari bankare, datë 16.02.2023, në BKT, në emër të Zhanina Proda, ku i kreditohen pagat, qiraja për periudhën 31.12.2015 - 16.02.2023. Gjendja në datën 16.03.2023 është në vlerën 14, 290 lekë.

Procedura e vlerësimit:

BKT, me shkesën nr. ***, prot., datë 09.05.2023, konfirmon se Zhanina Proda ka llogari bankare me gjendje në datën 09.03.2023, në vlerën 44, 095 lekë.

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë verifikimi të llogarisë së personit të lidhur me subjektin e vlerësimit, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ku rezulton se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë llogari bankare të subjektit. Deklarimi përputhet me dokumentacionin e administruar.

Deklarimi i të ardhurave nga personi i lidhur me subjektin e vlerësimit

- ❖ Të ardhura nga paga si arkitekte në studion e arkitekturës “*** sh.p.k”, nga data 01.01.2008 deri në 30.06.2008, shuma totale rreth 126, 000 lekë. Kontributet janë derdhur në ISSH, për pagën minimale. Vlera 126, 000 lekë.
- ❖ Të ardhura nga paga si arkitekte në studion e arkitekturës “*** Studio”, nga data 05.06.2008 deri në 27.01.2011, derdhur në llogarinë rrjedhëse nr. *****, banka BKT, shuma totale 563, 051 lekë. Kontributet janë derdhur në ISSH për pagën minimale. Vlera 563, 051 lekë.
- ❖ Të ardhura nga paga si arkitekte në studion e arkitekturës “*** sh.p.k” dhe “***” nga data 03.09.2013 deri në 30.11.2013, shuma totale rreth 63, 000 lekë. Kontributet janë derdhur në ISSH për pagën minimale. Vlera 63, 000 lekë.
- ❖ Të ardhura nga paga si specialiste në institucionin Aluizni, Tiranë, nga data 01.08.2014 deri në dhjetor 2015, derdhur në llogarinë rrjedhëse nr. ***, banka Credins, shuma totale 864, 571 lekë. Vlera 864, 571 lekë.
- ❖ Të ardhura nga paga, dieta dhe shpërblime nga funksioni si shefe sektori në institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Tiranë, nga data 31.12.2015 deri në datë 30.03.2018, derdhur në llogarinë rrjedhëse nr. **. Banka BKT, shuma totale 1, 950, 485 lekë. Shuma totale 1, 950, 485 lekë.
- ❖ Të ardhura nga paga, si përgjegjës sektori në institucionin Rezidenca Studentore Universitare Nr. 2, Tiranë, nga muaji maj 2015 deri në korrik 2019, derdhur në llogarinë rrjedhëse nr. **, banka Credins, shuma totale 928, 207 lekë. Shuma totale 928, 207 lekë.
- ❖ Të ardhura nga paga, dieta dhe shpërblime si Drejtor, i Drejtorisë Teknike në Entin Kombëtar të Banesave, nga muaji korrik 2019 deri në maj 2022, derdhur në llogarinë rrjedhëse nr. **, banka Credins, shuma totale 2, 923, 022 lekë. Shuma totale 2, 923, 022 lekë.
- ❖ Të ardhura nga paga, si specialist në institucionin Agjencia Shtetërore e Kadastrës, nga muaji qershor 2022 deri në shkurt 2023, derdhur në llogarinë rrjedhëse nr. **, banka Credins, shuma totale 541, 683 lekë. Shuma totale 541, 683 lekë.
- ❖ Të ardhura nga puna private si arkitekte nga viti 2006 deri në vitin 2016, shuma totale 12, 000 euro. Shuma totale prej 12, 000 euro.

Bashkëlidhur deklaratës:

- ✓ Nxjerrje llogari bankare, datë 16.02.2023, në Credins Bank, në emër të Zhanina Proda, ku i kreditohen pagat për periudhën 01.01.2018 - 16.02.2023.
- ✓ Nxjerrje llogari bankare datë 16.02.2023, në BKT, në emër të Zhanina Proda, ku i kreditohen pagat nga DPSHTRR, nga Agjencia e Ofrimit të Shërbimit Publik, dhe nga qiraja, për periudhën 31.12.2015 - 16.02.2023.

- ✓ Nxjerrje llogari bankare datë 12.04.2018, në Credins Bank, në emër të Zhanina Proda, ku i kreditohen pagat nga Aluizni, Qarku Tiranë, për periudhën 01.08.2014 – 08.01.2016.
- ✓ Librezë pune, ku shtetasja Zhanina Proda ka qenë e punësuar pranë subjektit “**** sh.p.k”, për periudhën 01.01.2008 - 30.06.2008, gjithashtu ka qenë e punësuar pranë “**** sh.p.k” dhe “****” për periudhën 03.09.2013 - 30.09.2013 dhe 01.10.2013 - 30.11.2013.

Procedura e vlerësimit:

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë kontrolli për të ardhurat e deklaruara nga personi i lidhur me subjektin e vlerësimit, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke analizuar të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion në funksion të hetimit administrativ, nga ku rezulton se:

BKT, me shkresën nr. ***, prot., datë 09.05.2023, përcjell nxjerrje llogari bankare të Zhanina Proda, ku kreditohen pagat dhe shpërblimet për periudhën 15.12.2015 - 30.03.2018 nga DPSHTRR, në vlerën 2, 074, 179 lekë. Në shkurt 2023 - mars 2023 është kredituar paga, nga Agjencia e Ofrimit të Shërbimit Publik, në vlerën 99, 506 lekë.

BKT, me postën elektronike të datës 26.09.2023, ka përcjell nxjerrje llogarie bankare të Zhanina Proda, ku kreditohen pagat nga “**** Studio”, për periudhën 05.06.2009 deri në 18.08.2011, shuma totale 511, 551 lekë.

Credins Bank, me shkresën nr. ***, prot., datë 30.05.2023, përcjell nxjerrje llogari bankare të Zhanina Proda, ku kreditohen pagat dhe shpërblimet për periudhën 01.08.2014 - 10.03.2023, nga Aluizni, Enti Kombëtar i Banesave dhe Rezidenca Studentore Universitare, në vlerën 5, 241, 694 lekë.

Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, me shkresën nr. ***, prot. datë 05.05.2023, konfirmon se shtetasja Zhanina Proda, figuron e regjistruar si individ privat, me përgjegjësi tatimore “Diva”. Nga ana e kësaj shtetase është kryer deklarimi individual vjetor i të ardhurave për vitin 2022. Bashkëlidhur: Deklarimi individual vjetor për të ardhurat në vitin 2022.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore, me shkresën nr. ***, prot., datë 10.05.2023, konfirmon të ardhura të realizuara nga shtetasja Zhanina Proda gjatë periudhës shtator 2013 - mars 2023, pranë subjekteve “****”, “****”, Aluizni, Tiranë, Aluizni, Tirana Rurale, Drejtoria Vendore e ASHK Tiranë Rurale 1, Drejtoria Aluizni Tirana 5, Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor, Rezidenca Studentore Universitare nr. 2, Enti Kombëtar i Banesave, Drejtoria e Përgjithshme e ASHK, Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara. (Të ardhurat neto nga punësimi në “****”, “****”, për periudhën shtator - nëntor 2013, rezultojnë në shumën 111, 000 lekë).

Drejtoria e Arkivit Qendror të Sigurimeve Shoqërore, me shkresë nr. 15403, datë 24.11.2023, konfirmon të ardhura bruto nga subjekti “****” sh.p.k për periudhën prill 2008 – qershor 2009, në shumën 369, 600 lekë.

Lidhur me të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja e subjektit të vlerësimit, sqaron se pagesat e bashkëshortes të përfituara për periudhën 01.01.2008 – 30.06.2008, nuk janë kredituar në sistemin bankar, sepse për atë periudhë nuk kanë qenë të detyrueshme ligjrisht. Për këtë periudhë bashkëshortja ka vetëm librezën e punës të plotësuar nga punëdhënësi, ku vërtetohet pagesa e kryer

dhe derdhja e kontributeve në ISSH. Nga data 05.06.2008 deri në datë 05.06.2009, pagesat janë bërë jashtë sistemit bankar dhe pagesat pasqyrohen në librezën e punës ku vërtetohet kryerja e pagesave. Për subjektin “****”, nga data 05.06.2009 dhe në vazhdim deri në datë 27.01.2011 për shkak të ligjit të kohës pagesat kryheshin në sistemin bankar, e konkretisht nëpërmjet BKT.

Në lidhje me deklarimin e të ardhurave nga bashkëshortja, në shumën 12, 000 euro, subjekti sqaroi se bashkëshortja Zhanina Proda ka qenë e punësuar në subjekte private si arkitekte dhe kjo vërtetohet nga librezat e punës bashkëlidhur, gjithashtu ajo ka kryer dhe punë të shkëputura (projekte arkitekturore individuale), për subjekte të tjera kundrejt pagesave të ndryshme. Duke qenë se këto punë janë kryer për llogari të subjekteve private të regjistruar si tatim pagues dhe jo individ, edhe detyrimi për tu paguar tatimi mbi të ardhurat për pagesat e përfituara referuar ligjit i lind punëdhënësit. Në dijeninë e tij shoqëritë kanë qenë korrekte me pagesën e detyrimeve.

Bashkëlidhur sqarimeve subjekti paraqiti:

- Librezat e punës për periudhat respektive.
- Deklaratë noteriale nr. ***, datë 21.06.2023, me deklarues S. I, i cili deklaroi se ushtron aktivitet në fushën e bar - restorantit dhe administron disa bare në qytetin e Durrësit. Në vitin 2011, shtetasja Zhanina Proda, ka kryer projektin arkitektonik të “Bar Restorant ****”, në Gjirin e Lalzit. Projekti konsistonte në arkitekturën e interierit, arredimit të ambienteve të hapura, si dhe ndjekjen e punimeve gjatë ndërtimit. Për punën e kryer, Zhanina Proda është paguar cash në shumën 3, 000 euro. Bashkëlidhur kartë identiteti e shtetasit S. I.
- Deklaratë noteriale nr. 3274/761, datë 20.06.2023, me deklarues Rr. B, i cili deklaroi se është administrator pranë shoqërisë “**** sh.p.k.”, me Nipt J*****U, themeluar nga viti 1995 e në vijim. Prej vitit 2005 e në vazhdim, shtetasja Zhanina Proda, ka qenë e punësuar si arkitekte e jashtme pranë kësaj shoqërie, duke realizuar projektin arkitektonik të objekteve të tipologjive të ndryshme në Shqipëri, për të cilat është paguar cash.
- Nga viti 2005 deri në vitin 2008 ka realizuar punët e mëposhtme:
 - ✓ Hotel dhe shërbime 3k+2k papafingo në Tale (2005), paguar 1, 500 euro për punën e kryer.
 - ✓ Plan vendosje pikë karburanti në pronësi të N. V (2006), paguar 500 euro për punën e kryer.
 - ✓ Pikë karburanti në Shkodër (2007), paguar 500 euro për punën e kryer.
- Nga viti 2009 deri në vitin 2012, ka realizuar punët e mëposhtme:
 - ✓ Hotel dhe shërbime 5k+ papafingo në Borsh (2009), paguar 3, 000 euro për punën e kryer.
 - ✓ Projekt magazinash (2009), paguar me 500 euro për punën e kryer
 - ✓ Objekt banimi dhe shërbimesh 5k në Lezhë (2010), paguar me 1, 000 euro, për punën e kryer.
 - ✓ Projekt stallash në Qerret, Durrës, për shoqërinë “****” sh.p.k (2012), paguar me 500 euro për punën e kryer.
- Nga viti 2013 deri në vitin 2016 ka realizuar punët e mëposhtme:
 - ✓ Realizim i arkitekturës së jashtme 3D dhe pamje teknike të një objekti “Hotel dhe shërbime 4K+ papafingo në Pogradec”, buzë rrugës nacionale (2013), paguar me 1, 000 euro, për punën e kryer.
 - ✓ Shtesë kati dhe adoptim objekti në Ksamil “garsonierat” (2015), paguar me 500 euro për punën e kryer. Kartë identiteti shtetasit Rr. B, + licencë e shtetasit Rr. B, i diplomuar si Ing. ndërtimi.

Ekstrakt të regjistrimit tregtar, i regjistruar në QKB, të subjektit “*** sh.p.k”, me objekt “Fusha e ndërtimit, projektimit dhe mbikëqyrjes së tyre”, regjistruar nga data 03.04.1995, me administrator ortak i vetëm Rr. B.

- Licence nr. A.1091, datë 06.02.2012 dhe nr. A.1091/1, datë 14.05.2018, në emër të Zhanina Proda, si arkitekte.
- Vërtetim nga Njësia Administrative Ishëm, datë 08.01.2024.
- Kontratë për dhënie hapësire publike në përdorim, datë 31.07.2014.
- Projektet arkitekturore të kryera nga Znj. Zhanina Proda.

Konkluzion:

- *Nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me llogaritë bankare të deklaruar nga Znj. Zhanina Proda pranë BKT dhe Credins Bank.*
- *Deklarimi përputhet me dokumentacionin e administruar.*
- *Të ardhurat nga pagat e bashkëshortes të konfirmuara nga institucionet bankare dhe dokumentacioni i dorëzuar për periudhën 2005 - 09.03.2023, janë në shumën totale rreth 8, 323, 379 lekë.*
- *Të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja e subjektit si arkitekte e jashtme për periudhën 2005 – 2015 janë në vlerën 12, 000 euro, konvertuar në total 1, 560, 000 lekë, dhënë cash nga punëdhënësit, për të cilat nuk vërtetohet fakti i pagesës së detyrimeve tatimore në organet përgjegjëse nga subjektet respektive.*

Deklarimi i detyrimeve financiare të personit të lidhur me subjektin e vlerësimit

1. Kredi bankare nga banka BKT, shuma 3, 390, 000 lekë, fillim i detyrimit më datë 27.08.2012, mbarimi i detyrimit më datë 29.08.2042. Interesi bazë i kredisë 3%, kësti mujor aktual 16, 050 lekë. Shuma e mbetur pa shlyer 2, 546, 445 lekë. Këstet e kredisë paguhen në llogarinë nr. *****, në emër të subjektit. **Trajtuar më lart.**
2. Huamarrje pa interes nga personi fizik shuma 52, 000 euro, fillimi i detyrimit më datë 01.02.2017, mbarimi detyrimit pa afat, deri në shlyerjen e shumës. Vërtetuar me deklaratë nr. ***, rep..dhe nr. ***, kol., datë 11.02.2017. **Trajtuar më lart.**

Shkresat e Institucioneve:

Banka e Shqipërisë, Intesa SanPaolo Bank, Banka e Bashkuar e Shqipërisë, Banka e Parë e Investimeve, Banka Union, Banka OTP Albania, Raiffeisen Leasing, Porsche Leasing, Albania Leasing Landesleasing, Raiffeisen Invest, Credins Invest, Unioni Financiar i Tiranës, AK Invest, Easypay, Fondi Besa, Institucioni Financiar Noa, Iutecredit Albania, Kredo Financë, konfirmojnë se Ilir Proda dhe personat e lidhur, nuk janë klientë të tyre, çka përputhet me deklarinimin.

Drejtoritë Vendore të ASHK, Librazhd, Fier, Krujë, Devoll, Korçë, Berat, Gjirokastrë, Pogradec, Mallakastër, Kamëz Vorë, Lushnjë, Gramsh, Malësi e Madhe, Kavajë, Kuçovë, Elbasan, Kolonjë, Has, Skrapar, Kukës, Durrës, Peqin, Tepelenë, Përmet, Mirditë, Tropojë, Bulqizë, Pukë, Mat,

Sarandë, Shkodër, Vlorë, Dibër, Kurbin (me postë elektronike), Lezhë, në përgjigjet e tyre nuk konfirmojnë pasuri të regjistruara në emër të subjektit dhe persona të lidhur me të.

BKT, me shkresën nr. ***, prot., datë 09.05.2023, konfirmon se Zhanina Proda ka pasur llogari bankare në monedhën euro, me gjendje në datë 09.03.2023, në vlerën 0 euro. Bashkëlidhur, nxjerrje llogari bankare, ku në datën 11.10.2011, është depozituar shuma 2, 000 euro në llogari, e cila ka kaluar në depozitë bankare. Në datën 24.01.2012 është tërhequr shuma 2, 000 euro.

Banka ProCredit, me shkresën nr. ***, prot., datë 04.05.2023, konfirmon se Zhanina Proda ka pasur llogari bankare, e cila rezulton e mbyllur në datën 01.09.2011. Bashkëlidhur, nxjerrje llogari bankare, (depozitë në vlerën 300, 000 lekë dhe depozitë në monedhën euro 2, 000 euro).

Nga verifikimi i llogarisë bankare në lekë të Znj. Zhanina Proda, rezulton se:

- ✓ Më datë 11.01.2008, janë kredituar në llogarinë rrjedhëse 200, 000 lekë, të cilat janë transferuar në depozitën e çelur më datë 11.01.2008. Nga kjo depozitë është fituar interes prej 5, 883 lekë.
- ✓ Depozita në lekë është mbyllur më datë 11.07.2008, ku është tërhequr shuma prej 200, 000 lekë dhe më pas është kredituar në llogarinë rrjedhëse.
- ✓ Më datë 21.07.2008 janë kredituar në llogarinë rrjedhëse 100, 000 lekë, dhe shuma në total prej 300, 000 lekë është transferuar në një depozitë tjetër që është çelur më datë 21.07.2008.
- ✓ Kjo depozitë është mbyllur më datë 13.08.2010, ku është tërhequr shuma prej 300, 000 lekë dhe më pas është kredituar në llogarinë rrjedhëse.
- ✓ Më datë 13.08.2010, shuma prej 300, 000 lekës është transferuar në llogarinë e A. R me përshkrimin “Zhanina Bajrami te A. R”.
- ✓ Interesi i fituar nga kjo llogari ka qenë 16, 129 lekë, dhe është tërhequr më datë 31.08.2010.

Sa më sipër subjekti i vlerësimit ka dhënë shpjegimet përkatëse, duke u shprehur se shuma prej 300, 000 lekë, është dhënë në formë borxhi në datë 13.08.2010 nga Zhanina Proda drejt motrës së saj A. R, e cila e ka kthyer këtë shumë në rrugë jashtë sistemit bankar në vitin 2012, kur kanë filluar transaksionet për të blerë apartamentin në datë 13.06.2012. Shuma në fjalë ka qenë kursime personale të krijuara nga Zhanina Bajrami (Proda), nga të ardhurat e saj nga puna si arkitekte, kursime të krijuara në kohën kur nuk ka qenë subjekt i lidhur me të pasi martesë është lidhur në qershor të vitit 2010.

Nga verifikimi i llogarisë në euro rezulton se:

- ✓ Më datë 20.05.2009 janë kredituar në llogarinë rrjedhëse 2, 000 euro, të cilat janë transferuar në depozitën e çelur më datë 20.05.2009. Nga kjo depozitë është fituar një interes prej 15, 88 euro.
- ✓ Depozita në euro është mbyllur më datë 28.07.2009, ku është tërhequr shuma prej 2, 000 euro dhe më pas është kredituar në llogarinë rrjedhëse.
- ✓ Më datë 28.07.2009 janë tërhequr nga llogaria 2, 000 euro me përshkrimin “Tërheq Zhanina Bajrami”.

Sa më sipër subjekti i vlerësimit ka dhënë sqarime se shuma prej 2, 000 euro janë kursime personale të krijuar nga bashkëshortja e tij nga të ardhurat nga puna si arkitekte, kursime të krijuara në kohën kur nuk ka qenë subjekt i lidhur me të.

Banka Amerikane e Investimeve, me shkresën nr. ***, prot., datë 09.05.2023, konfirmon se Zhanina Proda ka pasur vetëm kartë ID, por nuk ka pasur llogari bankare. Kristi Proda ka pasur llogari për bebe të porsalindur, e çelur në datën 07.12.2010, mbyllur në datë 17.01.2013. Bashkëlidhur, nxjerrje llogari bankare.

Drejtorja e Arkivit Qendror, me shkresën me nr.***, prot., datë 16.05.2023, përcjell informacion se për shtetasen Majlinda Proda, nuk figurojnë të dhëna për vjetërsinë në punë.

Drejtorja e Përgjithshme Detare, me shkresën nr. ***, prot., datë 10.05.2023, konfirmon se nuk rezultojnë të regjistruara mjete lundruese në pronësi të subjektit dhe personave të lidhur me të.

Regjistri Noterial Shqiptar, Ministria e Drejtësisë, me shkresë nr. ***, prot., datë 20.12.2023, ka përcjellë informacionin për të gjitha veprimet dhe aktet noteriale të regjistruara në sistemin RNSH për periudhën 01.03.2013 deri në datën 12.09.2023, të kryera nga noterë të ndryshëm për subjektin dhe personat e lidhur me të.

Nga verifikimi i të dhënave të vëna në dispozicion nga institucioni përkatës, ka rezultuar se:

1. Më datë 01.07.2013, është nënshkruar një kontratë qiraje me afat 1 vjeçare, për apartament banimi ndodhur në Lagjen nr. 4, Sarandë, ndërmjet bashkëshortes Zhanina Proda, në cilësinë e qiramarrëses dhe shtetasit E.B, në cilësinë e qiradhënësit.

Lidhur sa më sipër, pasuria në përdorim/posedim nga Znj. Proda, nuk është pasqyruar në deklaratën e pasurisë, sipas nenit 33, pika 1/a, e Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

Subjekti i vlerësimit, sa i përket faktit të konstatuar nga Trupa e Vlerësimit, ka dhënë sqarimet përkatëse duke u shprehur se: *“...Nga ana ime, ky fakt nuk është deklaruar në deklaratën e pasurisë, për arsye se kjo kontratë nuk është konsumuar dhe ky apartament as është poseduar dhe as përdorur nga unë apo familjarët e mi. Theksoj se bashkëshortja ime, as unë, apo ndonjë pjesëtar i familjes time, nuk ka poseduar për rrjedhojë edhe përdorur për asnjë moment apartamentin për të cilin është rënë dakord në kontratën e qirasë.*

Në vitin 2013, për shkak se unë jam transferuar në atë kohë nga Tirana me detyrë në Policinë e Lezhës, më ka lindur ideja që bashkëshortja së bashku me vajzën time të jetonin pranë familjeve tona që janë me banim edhe aktualisht në Sarandë. Për këtë arsye është lidhur kjo kontratë qiraje por duke rivlerësuar më pas të gjitha kushtet familjare, si dhe pamundësinë që kishte bashkëshortja për të ndjekur punët e saj nga Saranda, jemi tërhequr nga ky vendim për të jetuar në Sarandë dhe për këtë arsye kontrata nuk është konsumuar.

Shtoj se kjo kontratë nuk është anuluar përpara noterit ku është lidhur, për shkak të marrëdhënies së besimit midis palëve, pasi sqaroj se në kohën e lidhjes së kësaj kontrate, shtetasi E. B ka qenë i martuar me hallën time M. P (B) dhe për rrjedhojë ai nuk ka kërkuar as dëmshpërblim dhe nuk ka parë të arsyeshme anulimin juridik të kontratës...”

Bashkëlidhur shpjegimeve, subjekti i vlerësimit ka vënë në dispozicion të Trupës së Vlerësimit, deklaratë noteriale datë 07.02.2024, të shtetasit E. B, nënshkruar përpara noteres L. A, në Athinë, nëpërmjet të cilës vërteton faktet e mësipërme, dhe ndër të tjera citon se nuk ka marrë asnjë shumë

parash në lidhje me kontratën, sepse nuk ia ka dorëzuar banesën e mësipërme Znj. Zhanina Proda dhe ajo nuk ka jetuar ndonjëherë në banesën e përmendur.

Konkluzion:

- *Subjekti dha shpjegime për sa konfirmuar nga BKT dhe ProCredit Bank, të cilat janë vlerësuar dhe marrë në konsideratë nga Trupa e Vlerësimit.*
- *Sa i përket depozitave bankare respektive, ka rezultuar se bashkëshortja e subjektit të vlerësimit ka patur mundësi kursimi për krijimin e vlerave monetare me qëllim depozitimin pranë institucioneve bankare.*
- *Lidhur me kontratën e qirasë për apartament banimi ndodhur në Lagjen nr. 4, Sarandë, subjekti i vlerësimit dha shpjegime dhe dorëzoi dokumentacion justifikues ligjor, administruar vlerësuar dhe marrë në konsideratë nga Trupa e Vlerësimit.*

B. KONTROLLI I FIGURËS

Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.”

✚ Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në këto elementë:

- Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, sipas përcaktimeve të nenit 36, pika 1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar;
- Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;
- Procedura verifikuese nga Trupa e vlerësimit që konsiston në:
 - verifikimin e informacioneve në lidhje me aktivitetin, veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të nenit 36, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar;
 - identifikimin nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në veprimtari kriminale;
 - analizimin dhe kryqëzimin e dokumentacionit të administruar me deklaratimet e subjektit të vlerësimit.

Deklarimi i subjektit të vlerësimit

Në deklaratën e kontrollit të figurës, subjekti ka deklaruar se:

- Nuk është dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj.
- Nuk ka qenë asnjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet shqiptar ose i huaj për kryerjen e një vepre penale.

- Nuk ka qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare apo të huaja për kryerjen e një veprë penale.
- Nuk ka qenë caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo.
- Nuk është lëshuar asnjëherë ndaj tij një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale.
- Nuk është marrë asnjëherë masë dëbimi nga një shtet i huaj.
- Nuk ka dijeni se ndonjë nga anëtarët e familjes së tij bashkëshortja, fëmijët, si dhe personat e përfshirë në certifikatën familjare, është përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.
- Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme në formën e takimit, komunikimit elektronik, ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës së subjektit.
- Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk është në dijeni që një nga anëtarët e familjes së tij të kenë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka dijeni se një person i familjes, ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s gjatë 10 viteve të fundit.
- Nuk ka patur procedime penale dhe administrative, brenda dhe jashtë vendit, sipas neneve të ligjit për garantimin dhe integritetin e personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.
- Nuk ka fshehur apo keq prezantuar, falsifikuar një informacion të një rëndësie të madhe, të një natyre sigurie të veçantë apo të ketë gënjer gjatë plotësimit të formularit të deklaratës së kontrollit të figurës.
- Nuk ka kryer shkelje sigurie, apo të ketë nëpërkëmbur në mënyrë të përsëritur rregullat e sigurisë së informacionit të klasifikuar, apo të ketë tentuar të kryej aktivitet të paautorizuar në sistemet e komunikimit të informacionit të klasifikuar.
- Nuk ka kërkuar azil politik në ndonjë shtet.
- Nuk është përdorues i lëndëve narkotike.
- Nuk ka pasur asnjëherë varësi ndaj alkoolit apo lojërave të fatit.
- Nuk ka vuajtur nga ç ’rregullime mendore kronike.
- Nuk ka qenë asnjëherë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Ish- Sigurimi i Shtetit para vitit 1991, sipas Ligjit nr. 45/2015, “Mbi të drejtën e informimit me dokumentet e ish – shërbimit të sigurimit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

Po ashtu, subjekti ka nënshkruar edhe dy vet deklaratimet për vërtetësinë e të dhënave dhe saktësinë e tyre, të paraqitura në deklaratën e kontrollit të figurës, si dhe deklaratën për dhënien e pëlqimit për mbledhjen e të dhënave, kryerjen e kontrollit të figurës dhe aksesin për njohjen dhe administrimin e të dhënave personale.

Procedura verifikuese

Për të vijuar me kontrollin tërësor të figurës dhe saktësinë e deklaramit të subjektit të vlerësimit lidhur me këtë aspekt, në bazë të nenit 36 dhe nenit 37, të Ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, janë kryer veprimet e tjera duke kërkuar të dhëna nga institucionet përgjegjëse, të shprehura në këtë ligj si më poshtë:

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, për subjektin e vlerësimit Z. Ilir Proda, me shkresën nr. ***, prot., datë 26.06.2023, bën me dije se me vendim gjykate, datë 14.11.1998, ka ndryshuar vitin e lindjes nga 1982 në 1983.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me shkresat nr. ***, prot., datë 19.05.2023 dhe datë 22.12.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Ilir Proda dhe Znj. Zhanina Proda, bën me dije se nuk rezultojnë të dënuar nga gjykatat penale shqiptare.

Institucioni Ligjzbatues, me shkresën nr. ***, prot., datë 31.05.2023, ka konfirmuar të dhëna referuese në ngarkim të subjektit të vlerësimit Z. Ilir Proda.

Të dhënat në ngarkim të subjektit të vlerësimit janë ndarë me institucionet e tjera ligjzbatuese, të cilat kanë kryer verifikimet përkatëse, ku ka rezultuar se:

- Nuk konfirmohet vërtetësia e tyre.
- Nuk ka fakte apo prova që subjekti i vlerësimit është i përfshirë ose i dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, apo që tregojnë që ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.
- Nuk rezulton që në emër të subjektit të vlerësimit të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.

Institucioni Ligjzbatues, me shkresën nr. *** prot., datë 30.05.2023, dhe shkresën nr. ***, datë 30.05.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Ilir Proda si dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare, bën me dije se:

- Nuk ka të dhëna për cenimin e figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejtë ose indirekt në veprime të dyshimta,
- Nuk ka të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar,
- Nuk ka të dhëna në lidhje nëse ka qenë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare apo të huaja, për kryerjen e një vepre penale,
- Nuk ka të dhëna në lidhje me hetimin ose gjykimin nga një autoritet shqiptar ose i huaj, për kryerjen e një vepre penale,
- Nuk ka të dhëna në lidhje me ndonjë masë dëbimi nga një shtet i huaj,
- Nuk ka të dhëna nëse gjatë 10 viteve i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s,
- Nuk ka të dhëna në lidhje me lëshimin e ndonjë urdhri ndërkombëtar, për kryerjen e një vepre penale,
- Nuk ka të dhëna nëse subjekti ka kërkuar azil politik në ndonjë shtet,
- Nuk ka procedim disiplinor apo masë disiplinore në ngarkim.

Institucioni Ligjzbatues, me shkresat nr. ***, prot., datë 08.06.2023 dhe datë 28.12.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Ilir Proda, bashkëshorten Znj. Zhanina Proda dhe personat e tjerë të lidhur, bën me dije se nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.

Institucioni Ligjzbatues, me shkresën nr. ***, prot., datë 31.05.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Ilir Proda, bën me dije se nuk disponon të dhëna.

Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit dhe Drejtoria e Inspektimit dhe Ankesave në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, me shkresat e datës 13.06.2023, shkresën nr. 455, datë 19.06.2023, dhe shkresën nr. ***, datë 26.05.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Ilir Proda dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare, bën me dije se:

- Nuk administrohen ankesa, të dhëna ose informacione që lidhen me objektin e kërkesës.
- Është regjistruar kallëzimi penal nr. ***, datë 01.12.2014, në ngarkim të subjektit të vlerësimit Ilir Proda, iniciuar me kallëzimin e një shtetasi, depozituar pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.

Sa i përket kallëzimit penal nr. ***, datë 01.12.2014, Prokurori i çështjes më datë 10.12.2014, ka vendosur të mos fillojë procedimin penal, duke konstatuar se nuk ndodhet para elementëve të ndonjë vepre penale, për të cilën organi i Prokurorisë është i detyruar të ushtrojë ndjekjen penale kryesisht apo të vazhdojë atë të iniciuar mbi bazë kallëzimi penal.

Institucioni Ligjzbatues, me shkresën nr. ***, prot., datë 25.05.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Ilir Proda, bën me dije se:

- Nuk është pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP) të vlefshme.
- Nuk është marrë vendim për refuzim, heqje apo pezullim të përkohshëm të CSP-së.
- Agjencia e Mbikëqyrjes Policore me shkresën nr. ***, prot., datë 04.11.2021, ka shprehur vlerësimin përkatës për Z. Proda dhe aktualisht është ende në proces.

Në kuadrin e procedurave të verifikimit të sigurisë për pajisjen me CSP të subjektit Z. Ilir Proda, për t'u njohur me informacionin e klasifikuar në nivelin "Tepër Sekret", struktura përgjegjëse është vënë në dijeni të të dhënave referuese në ngarkim të tij, dhe ka kryer procedura verifikuese, në përfundim të të cilave ka rezultuar se nuk konfirmohet vërtetësia e tyre.

Me shkresën nr. ***, prot., datë 27.07.2023, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore i është drejtuar institucionit përgjegjës me vlerësimin përkatës.

Trupa e Vlerësimit në kuadër të një hetimi objektiv dhe të gjithanshëm, me shkresë nr. ***, prot., datë 05.12.2023, i është drejtuar institucionit përgjegjës me qëllim informimin mbi ecurinë e procesit të verifikimit të sigurisë së personelit për subjektin e vlerësimit Z. Ilir Proda.

Institucioni Ligjzbatues, me shkresën nr. ***, prot., datë 20.12.2023, bën me dije se Z. Ilir Agim Proda, nuk është i pajisur me CSP të vlefshme, pasi është ende në proces.

Institucioni Ligjzbatues, me shkresat nr. ***, prot., datë 10.07.2023 dhe datë 07.02.2024, bën me dije se për subjektin e vlerësimit dhe bashkëshorten Znj. Zhanina Proda:

- Nuk është nxjerrë urdhër ndalimi.
- Nuk është kërkuar masë e sigurimit personal.
- Nuk është marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 35 të Kodit të Procedurës Penale.
- Nuk ka patur regjistrim të njoftimit të veprave penale.
- Nuk ka patur raste të urdhrave ndërkombëtar të ndalimit.

Avokati i Popullit, me shkresën nr. ***, prot., datë 30.05.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Ilir Proda, bën me dije se:

- Nuk ka njoftime apo ankesa nga publiku në lidhje me veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin gjatë kryerjes së detyrës.
- Nuk ka nisje të hetimit administrativ për shkelje të kryera nga subjekti.

Institucioni Ligjzbatues, me shkresën nr. ***, prot., datë 08.06.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Ilir Proda, bën me dije se për shkak të moshës së tij nën 14 vjeç, para 2 Korrikut 1991, nuk është subjekt verifikimi sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

Trupa e Vlerësimit, në kuadër të kontrollit të figurës të subjektit të vlerësimit, personave të lidhur dhe personave të tjerë të lidhur, ka kryer verifikime në institucionet përgjegjëse, dhe ka rezultuar se për subjektin e vlerësimit, nuk ka të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.

 **Testi** për përdorim lëndësh narkotike:

Subjekti i vlerësimit në zbatim të pikës 2, të nenit 38, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, si dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore dhe Institutit të Mjekësisë Ligjore “Për kryerjen e ekspertimeve toksikologjike”, ka kryer ekspertimin toksikologjik të një mostre urine, mbi përdorimin ose jo të lëndëve narkotike.

Me shkresë nr. ***, prot., datë 11.01.2024, protokolluar me nr. ***, prot., datë 15.01.2024, Instituti i Mjekësisë Ligjore ka dërguar dokumentacionin përkatës, analizuar dhe vlerësuar nga Trupa e Vlerësimit, konkretisht:

- Akt Ekspertimi Toksikologjiko – Ligjor nr. ***, datë 11.01.2024, për subjektin e vlerësimit Ilir Agim Proda.
- Deklaratë Eksperti

Në bazë të rezultateve të përfituara nga ekspertiza toksikologjike për përdorim lëndësh narkotike, konkludohet se subjekti vlerësimi Z. Ilir Proda, aktualisht nuk rezulton përdorues i lëndëve narkotike.

✚ Denoncimet nga publiku

Nga verifikimet e kryera nga Trupa e Vlerësimit, rezulton se nuk ka informacione të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin, veprimtarinë e subjektit të vlerësimit apo të personave të lidhur me të.

Konkluzion:

Trupa e Vlerësimit, në përputhje me Ligjin nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, nëpërmjet analizimit dhe verifikimit të të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, analizimin dhe verifikimin e të dhënave të mbledhura nga institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese, si dhe raportin e sjellë nga struktura përgjegjëse e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, arriti në konkluzionin se:

- *Rasti i kallëzimit penal trajtuar më sipër, nuk klasifikohet tek përcaktimet e nenit 42, pika 3, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.*
- *Lidhur me të dhënat referuese në ngarkim të subjektit të vlerësimit, janë verifikuar nga institucionet ligjzbatuese dhe në përfundim nuk është konfirmuar vërtetësia e tyre, nuk ka fakte apo prova që subjekti i vlerësimit është i përfshirë ose i dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.*
- *Për subjektin e vlerësimit, nuk ka të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.*
- *Sa i përket faktit të mos pajisjes me Certifikatë të Sigurisë së Personelit të subjektit të vlerësimit, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, pas procedurave verifikuese, i është drejtuar institucionit përgjegjës me vlerësimin përkatës, dhe çështja është ende në proces.*
- *Nuk ka informacione të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin, veprimtarinë e subjektit të vlerësimit apo të personave të lidhur me të.*
- *Nuk rezulton përdorues i lëndëve narkotike.*

C . VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale, është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45, 47, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të Policisë së Shtetit.

- ✚ Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në dy elemente:

- Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, e Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar;
- Raportin e përgatitur nga struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 2, e Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
- Procedura verifikuese nga Trupa e Vlerësimit, e cila konsiston në analizimin dhe kryqëzimin e informacioneve të vëna në dispozicion nga institucionet përgjegjëse, me deklarin e subjektit të vlerësimit.

Deklarimi i subjektit të vlerësimit

Në formularin e aftësive profesionale subjekti deklaron:

Të dhëna për arsimimin

- Arsim i Lartë Policor, Akademia e Rendit Publik, Viti 2002 – 2005.
- Fakulteti i Drejtësisë, Diplomë e Nivelit të Parë, Viti 2008 -2012.
- Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, Master i Shkencave në “E drejtë penale”, Viti 2013 – 2014.

Procedura e vlerësimit:

Subjekti i vlerësimit ka filluar studimet pranë Akademisë së Rendit Publik, në datë 01.09.2002 dhe i ka përfunduar në datë 18.07.2005. Në përfundim institucioni arsimor përkatës e ka titulluar “Specialist i lartë policie”, duke u pajisur me diplomën nr. 958-A.

Në vitin 2008 deri në vitin 2012, ka studiuar degën “Drejtësi”, niveli “Bachelor”, në Fakultetin e Drejtësisë Tiranë, duke u diplomuar dhe certifikuar pranë këtij Universiteti.

Gjithashtu subjekti i vlerësimit ka kryer Master Shkencor, në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Juridik, dega “E drejtë Penale” në periudhën 2012 – 2014. Në përfundim të studimeve është pajisur me diplomën përkatëse me titullin “Master i Shkencave në Shkenca Penale”.

Sipas legjislacionit për Policinë e Shtetit ndër vite dhe Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, VKM nr. 750, datë 16.09.2015 “Për miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit”, Trupa e Vlerësimit arrin në konkluzionin se subjekti i vlerësimit, që në kohën e emërimit në detyrë për herë të parë në Policinë e Shtetit dhe deri në vijueshmërinë e ecurisë në karrierë të tij, ka qenë në përmbushje të kriterit të nivelit arsimor dhe kualifikimit përkatës për funksionin që ka ushtruar dhe ushtron aktualisht.

Të dhëna për punësimin dhe ecuria në karrierë

Në pikat 2 dhe 3, të nenit 44, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, përcaktohet se “Periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit në gradën dhe/ose pozicionin që mban, por jo më shumë se 5 vjet.

Neni 45, pika 2, shkronja (dh), e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, përcakton se, në lidhje me objektin e vlerësimit të aftësive profesionale shërbejnë edhe ecuria në karrierë dhe procesi i fitimit të gradës, sipas legjislacionit në fuqi.

Struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ka në dispozicion dosjen e personelit të subjektit të vlerësimit, në të cilën përfshihen akte të ndryshme që i përkasin arsimimit, punësimit, ngritjes në detyrë, gradimeve, kualifikimeve, vlerësimeve etj., të cilat janë marrë në analizë nga Trupa e Vlerësimit, me qëllim vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të vlerësimit, konkretisht:

- *Kopje e Urdhrit të emërimit nr. 287, datë 19.05.2017, për Komisar Ilir Agim Proda, me detyrë Specialist, në Sektorin për Hetimin e Narkotikëve, në Drejtorinë për Hetimin e Narkotikëve dhe Trafiqet, në Drejtorinë e Përgjithshme për Krimin e Organizuar dhe Krimet e Rënda, për nevoja pune, të transferohet dhe të emërohet në detyrë Specialist, në Sektorin për Hetimin e Krimeve të Rënda kundër Personit, në Drejtorinë për Hetimin e Krimeve të Rënda, në Departamentin për Hetimin e Krimeve të Rënda dhe Krimin të Organizuar.*
- *Kopje e Urdhrit të emërimit nr. 1058/1, datë 04.05.2018, për Komisar Ilir Agim Proda, me detyrë Specialist, në Sektorin për Hetimin e Krimeve të Rënda kundër Personit, në Drejtorinë për Hetimin e Krimeve të Rënda, në Departamentin për Hetimin e Krimeve të Rënda dhe Krimin të Organizuar, për ndryshim të strukturës organike, të transferohet dhe të emërohet në detyrë Specialist, në Njësinë për Hetimin e Krimeve ndaj Personit, në Drejtorinë Hetimore Qendrore, në Departamentin e Policisë Kriminale, në DPPSH.*
- *Kopje e Urdhrit të emërimit nr. 152/1, datë 18.07.2019, për Kryekomisar Ilir Agim Proda, me detyrë Specialist, në Njësinë për Hetimin e Krimeve ndaj Personit, në Drejtorinë Hetimore Qendrore, në Departamentin e Policisë Kriminale, në DPPSH, për nevoja pune të transferohet dhe të emërohet në detyrë Zëvendësdrejtor për Hetimin e Krimeve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Korçë.*
- *Kopje e Urdhrit të emërimit nr. 1586, datë 22.10.2021, për Kryekomisar Ilir Agim Proda, me detyrë Zëvendësdrejtor për Hetimin e Krimeve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Korçë, për nevoja pune, të transferohet dhe të emërohet në detyrë Zëvendësdrejtor për Hetimin e Krimeve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan.*
- *Kopje e Urdhrit të emërimit nr. 481/1, datë 24.03.2023, për Kryekomisar Ilir Agim Proda, me detyrë Zëvendësdrejtor për Hetimin e Krimeve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan, për nevoja pune, të emërohet në detyrë Drejtor, në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan.*

Në formularin e aftësive profesionale plotësuar nga subjekti i vlerësimit si dhe nga dosja personale e subjektit, rezulton se 5 vitet e fundit, subjekti i vlerësimit ka punuar në funksionet si më poshtë:

- Nga data 10.06.2017 – 06.05.2018, me Urdhër nr. 287, datë 19.05.2017, subjekti i vlerësimit Z. Ilir Proda është emëruar me detyrë Specialist, në Sektorin për Hetimin e Krimeve të Rënda kundër Personit, në Drejtorinë për Hetimin e Krimeve të Rënda, në Departamentin për Hetimin

e Krimeve të Rënda dhe Krimit të Organizuar, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

- Nga data 07.05.2018 – 21.07.2019, me Urdhër nr. 1058/1, datë 04.05.2018, subjekti i vlerësimit është emëruar me detyrë Specialist, në Njësinë për Hetimin e Krimeve ndaj Personit, në Drejtorinë Hetimore Qendrore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
- Nga data 22.07.2019 – 18.10.2021, me Urdhër nr. 152/1, datë 18.07.2019, subjekti i vlerësimit është emëruar me detyrë Zëvendësdrejtor për Hetimin e Krimeve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Korçë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
- Nga data 19.10.2021 – 26.03.2023, me Urdhër nr. 1586, datë 22.10.2021, subjekti i vlerësimit është emëruar me detyrë Zëvendësdrejtor për Hetimin e Krimeve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
- Nga data 27.03.2023 dhe aktualisht, subjekti i vlerësimit mban detyrën e Drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, emëruar me Urdhër nr. 481/1, datë 24.03.2023.

Sa i përket procedurës për dhënien e gradës policore nga “Komisar” në “Kryekomisar”, me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 152, datë 07.02.2019 “Për dhënien e gradës policore një punonjësi policie”, Trupa e Vlerësimit mori në analizë kuadrin ligjor përkatës në kohën e veprimit të tij, e konkretisht:

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit të Policisë së Shtetit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, është miratuar VKM nr. 750, datë 16.09.2015 që miratonte Rregulloren e Personelit të Policisë së Shtetit. Sipas kësaj rregulloreje e cila zbatonte ligjin e ri të Policisë së Shtetit, si dhe ndër të tjera rregullat e marrëdhënies së punës, që nga rekrutimi i punonjësve të Policisë së Shtetit, trajnimin në shkollën bazë të Policisë së Shtetit, ecurinë në karrierë, në gradë etj., Trupa e Vlerësimit gjen të bazuar sipas dispozitës ligjore që përcakton kjo rregullore specifikisht se :

“Neni 161/1”, pika 1, “Kriteret për aplikim për gradimin e radhës”, i Rregullores së Policisë së Shtetit, miratuar me VKM nr. 750, datë 16.09.2015 përcakton se:

Punonjësi i policisë ka të drejtë të aplikojë për fitimin e gradës policore të radhës, kur plotëson kriteret e mëposhtme:

- a) të ketë vlerësim të aftësive individuale të punës (të performancës), jo më ulët se 70% të pikëve të vlerësimit të përgjithshëm, gjatë kohës së qëndrimit në gradë;
- b) të jetë parashkruar masa disiplinore për shkelje të rëndë, sipas afatit të përcaktuar në Ligjin “Për Policinë e Shtetit”;
- c) të mos ketë filluar ndaj tij procedimi penal;
- ç) të mos ketë filluar ndaj tij procedimi disiplinor për shkelje të rëndë;
- d) të ketë plotësuar kohën e qëndrimit në gradë sipas afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar.

“Neni 161/2”, pika 1, “Afatet e qëndrimit në gradë”, përcakton se:

Punonjësi i Policisë, për të aplikuar për gradën e radhës, duhet të plotësojë afatet e mëposhtme:

- a) nga “Inspektor” deri në “Inspektor i dytë”: 5 vjet;
- b) nga “Inspektor i dytë” në “Inspektor i parë”: 10 vjet;
- c) nga “Nënkomisar” në “Komisar”: 3 vjet;
- ç) nga “Komisar” në “Kryekomisar”: 3 vjet;
- d) nga “Kryekomisar” në “Drejtues”: 5 vjet;
- dh) nga “Drejtues” në “Drejtues i parë”: 3 vjet.

Bazuar në këto përcaktime, Trupa e Vlerësimit konstaton se subjekti ka plotësuar kriteret e përcaktuara në nenin 161/1 dhe nenin 161/2, të VKM nr. 750, datë 16.09.2015, me qëllim aplikimin për gradën nga Komisar në Kryekomisar.

Grada “Kryekomisar” dhënë subjektit bazohet në dokumentacionin si më poshtë:

- *Shkresë nr. 175/1, datë 31.01.2019, “Dërgojmë procesverbalin e provim certifikimin për fitimin e gradës “Kryekomisar” në Akademinë e Sigurisë.*
- *Urdhri nr. 152, datë 07.02.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, ku përmendet se Komisar Ilir Agim Proda i jepet grada policore “Kryekomisar”.*
- *Urdhri nr. 17, datë 10.01.2018 “Për miratimin e listës emërore të së drejtës për dhënie grade të aplikantëve fitues për fitimin e gradës policore “Kryekomisar”.*

Konkluzion:

- *Lidhur me ecurinë në gradë dhe në karrierë të subjektit të vlerësimit Z. Ilir Proda, arrijmë në konkluzion se gradat që subjekti i vlerësimit ka përfutuar gjatë karrierës, rezultojnë në përputhje dhe në zbatim me legjislacionin rregullator të kohës, ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.*

Vlerësimet e punës

Në aktet e depozituara pranë strukturës përgjegjëse të burimeve njerëzore të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, rezulton se gjatë 5 viteve të fundit 2018 - 2023, janë të administruara 3 vlerësime të aftësive individuale të subjektit të vlerësimit Z. Ilir Proda, konkretisht:

- Për vitin 2018, është vlerësuar me 27 pikë.
- Për vitin 2021, është vlerësuar me 28 pikë.
- Për vitin 2022, është vlerësuar me 100 pikë.

Konkluzion:

- *Nga verifikimet ka rezultuar se për vitin 2019, 2020, nuk është administruar vlerësimi i punës në dosjen e personelit të subjektit të vlerësimit, konfirmuar më shkresën e dërguar nga DPPSH me nr. 2645/124, prot., datë 10.08.2023.*
- *Nga analizimi i vlerësimeve të mësipërme, konstatohet se për periudhën 2018 – 2021, subjekti i vlerësimit është vlerësuar nga eprori i drejtpërdrejtë pothuajse me pikët maksimale.*

Përbushja e detyrave të kryera dhe respektimi i rregullave të etikës

Sipas Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, neni 43, objekti i vlerësimit të aftësive profesionale është dhe përbushja e detyrave nga punonjësi.

Gjithashtu në nenin 45, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, përcaktohet se aftësitë profesionale të punonjësit, vlerësohen duke u bazuar dhe në përshkrimet e punës për çdo funksion.

Nga verifikimi i dosjes së personelit, lidhur me përbushjet e detyrave të kryera evidentohet se gjatë periudhës objekt vlerësimit (2018 – 2023), nuk ka asnjë të dhënë që të evidentojë ndonjë masë disiplinore të ndërmarrë ndaj tij. Në këtë periudhë, subjekti ka ushtruar funksione të ndryshme dhe në rritje profesionale dhe me përgjegjësi të shtuara.

Bazuar në vlerësimet e mësipërme të administruara në dosjen personale të subjektit, konkludojmë se subjekti ka përbushur detyrat profesionale si dhe ka respektuar rregullat e etikës.

Kualifikimet dhe trajnimet:

Nga verifikimi i dosjes së personelit të subjektit të vlerësimit kalimtar Z. Ilir Agim Proda, si dhe formularit të aftësive profesionale të plotësuar nga subjekti, rezulton se është pajisur me certifikata për kryerje kursesh, shkollime dhe trajnime brenda dhe jashtë vendit, konkretisht:

- Certifikatë për fitimin e gradës Kryekomisar. Viti 2019
- Certifikatë trajnimi me objekt “Të drejtat e njeriut dhe minoritetet”, kryer në Holandë në vitin 2019.
- Certifikatë pjesëmarrje në kursin me objekt “Seminar i ndërgjegjësimit të palëve të interesuara”, kryer në vitin 2017.
- Certifikatë trajnimi me objekt “Kurs trajnimi për vlerësimin e rrezikut dhe kërcënimit”. Viti 2018.
- Certifikatë trajnimi me objekt “Roli i Policisë së Shtetit në zbatimin e legjislacionit kundër dhunës në familje”, kryer në vitin 2008.
- Certifikatë trajnimi me objekt “Të drejtat e njeriut dhe pakicave”, kryer në vitin 2019.
- Certifikatë për mbrojtjen e gjuhës angleze në vitin 2014.

- Certifikatë për shërbime të dalluara “Për punë cilësore, angazhim maksimal, profesionalizëm, duke arritur rezultate të larta në parandalimin dhe goditjen e elementëve kriminal”. Datë 11.01.2014.
- Certifikatë për shërbime të dalluara “Për rezultate të larta në luftën kundër krimit, e veçanërisht kundër krimit të organizuar”. Datë 30.05.2022.
- Certifikatë për shërbime të dalluara “Për përkushtimin, profesionalizmin dhe aftësitë menaxhuese të treguar, në përmbushjen cilësore të detyrave, në shërbim të Policisë së Shtetit”. Datë 10.01.2023.
- Medalje për Trimëri “Për merita të veçanta në luftë ndaj krimit, sigurimit të rendit dhe të qetësisë, profesionalizmit dhe përkushtimit të treguar, duke rrezikuar edhe jetën në përmbushjen cilësore të detyrave, në shërbim të Policisë së Shtetit”. Datë 12.01.2024.

Bazuar në nenin 44, pika 2, të Ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar, përcaktohet se periudha e vlerësimit të aftësive profesionale, përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit në gradën dhe/ose pozicionin që mban, por jo më shumë se 5 vjet.

Në nenin 45, pika 2, përcaktohet objekti i vlerësimit të aftësive profesionale, ku një ndër to shërbejnë dhe certifikatat e trajnimeve.

Nga verifikimet, rezulton se gjatë periudhës objekt vlerësimi (2018 – 2023), subjekti i vlerësimit ka marrë 2 certifikata për shërbime të dalluara konkretisht në vitin 2022 dhe muajin janar 2023, si dhe ka marrë pjesë në workshop në Austri, me tematikë “Grupet kriminale ballkanike dhe krimet e kryera nga grupet etnike kriminale në Ballkan”. Gjithashtu subjekti i vlerësimit ka kryer 3 trajnime përgjatë periudhës objekt vlerësimi.

Konkluzion përfundimtar:

Në përfundim të verifikimeve të kryera nga Trupa e Vlerësimit lidhur me vlerësimin profesional arrihet në konkluzionin se:

- *Subjekti i vlerësimit ka qenë në përmbushje të kriterit të nivelit arsimor dhe kualifikimit përkatës për funksionin që ka ushtruar dhe ushtron aktualisht.*
- *Për vitin 2019 dhe vitin 2020, nuk është administruar vlerësimi i punës në dosjen e personelit të subjektit të vlerësimit.*
- *Për periudhën 2018 – 2021, subjekti i vlerësimit është vlerësuar nga eprori i drejtpërdrejtë pothuajse me pikët maksimale.*
- *Gradat që subjekti i vlerësimit ka përfituar gjatë karrierës, rezultojnë në përputhje dhe në zbatim me legjislacionin rregullator të kohës, ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.*
- *Gjatë periudhës objekt vlerësimi (2018 – 2023), nuk ka asnjë të dhënë që të evidentojë ndonjë masë disiplinore të ndërmarrë ndaj subjektit të vlerësimit.*
- *Subjekti i vlerësimit ka kryer trajnime përgjatë periudhës objekt vlerësimi, si dhe ka marrë certifikata për shërbime të dalluara, ka përmbushur detyrat profesionale, respektuar rregullat e etikës si dhe ka shfaqur performancë të lartë në kryerjen e detyrave funksionale.*

KONKLZIONI PËRFUNDIMTAR:

Trupa e Vlerësimit, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara gjatë procesit të vlerësimit, relacionin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e vlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha provat dhe shpjegimet nga subjekti i vlerësimit, në përfundim të procesit të vlerësimit, arrin në konkluzionin se subjekti i vlerësimit, Ilir Agim Proda, në përputhje me nenin 60, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka plotësuar së bashku tre kushtet e mëposhtme:

- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollin e figurës;
- Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale;

PËR KËTO ARSYE:

Trupa e Vlerësimit, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në pikën 7, pikën 8, të nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në mbështetje të shkronjës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës “1” dhe “2” të nenit 60, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit **Ilir Agim Proda**, me detyrë Drejtor, në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
1. Vendimi i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.
2. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim, brenda 45 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim u shpall sot, më datë 08.03.2024, në Tiranë.

TRUPA E VLERËSIMIT

KRYESUESE

Bora VRENJO

RELATOR

Henri NAQELLARI

ANËTARE

Loreta HANXHARI

Aneks 1:

Pasqyra e analizës financiare

	Pasqyra e Analizës Financiare															
Burimi/Viti	2005-2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	09.03.2023
Të ardhura neto nga paga apo shperblime nga marredheniet e punesimit, Të ardhura nga qiraja	1,836,899	579,797	1,276,100	1,349,724	796,610	868,500	1,263,962	1,433,457	2,022,187	1,728,919	1,858,838	2,225,469	2,426,754	2,254,515	2,428,140	484,024
Të ardhura nga shitja e pasurive të luajtshme ose të paluajtshme								138,000		414,000				200,000		
Të ardhura të papërmendura më sipër				300,000	200,000					500,000						
Totali i të Ardhurave neto	1,836,899	579,797	1,276,100	1,649,724	996,610	868,500	1,263,962	1,571,457	2,022,187	2,642,919	1,858,838	2,225,469	2,426,754	2,454,515	2,428,140	484,024
Detyrime: Te hyra nga huate/kredi/dhurim																
Shpenzime jetike sipas INSTAT	593,772	213,252	515,359	639,756	418,644	418,644	860,844	822,552	916,740	970,500	1,028,868	1,107,192	1,118,700	1,138,608	1,188,144	891,108
Shpenzime per Qera																
Shpenzime për Mjekim											109,000					
Shpenzime për Arsimin		93,600	93,600	93,600	62,400									60,000	50,000	
Shpenzime Udhëtimi jashte vendit											96,600	156,000		78,000	88,200	
Detyrime Kredie Bankare Leasing, etj					60,500	184,200	187,000	173,900	177,500	157,300	866,600	585,600	185,900	1,137,600	1,039,300	57,200
Shpenzime dhe te dala te tjera.					360,000					500,000						
Totali i shpenzimeve dhe te dalave	593,772	306,852	608,959	733,356	901,544	602,844	1,047,844	996,452	1,094,240	1,627,800	2,101,068	1,848,792	1,304,600	2,414,208	2,365,644	948,308
Investime.pasuri					486,500		200,000		402,000	25,000						104,000
Likuiditete		414,000		828,000					1,800,000	201,000						549,694
Gjendje Cash																
Totali Pasuri	-	414,000	-	828,000	486,500	-	200,000	-	2,202,000	226,000	-	-	-	-	-	653,694
Mundësia per Kursime	1,243,127	1,102,072	1,769,213	1,857,581	1,466,147	1,731,803	1,747,921	2,322,926	1,048,873	1,837,992	1,595,762	1,972,439	3,094,593	3,134,900	3,197,396	2,079,418